



BASHKIA VAU I DEJËS



PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË VAU I DEJËS



BASHKIA VAU I DEJËS

PLANI STRATEGJIK

I ZHVILLIMIT

TË BASHKISË VAU I DEJËS



Përgatitur nga: BASHKIA VAU I DEJËS

Mbështetur nga: Intercooperation Albania, Programi për Decentralizimin dhe Zhvillimin Vendor (dldp)
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, Shqipëri URBAPLAN, Zvicer

Financuar nga: SDC – Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim

Vau i Dejës - 2008

Realizimi Grafik: CREOstd

Shtypur në: Botime AFROJDIT




Tabela e Përmbajtjes

| | |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
| FJALA PËRSHËNDETËSE | 5 |
| MIRËNJOHJE | 7 |
| HYRJE | 9 |
| KAPITULLI I | |
| 1.1 Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Vau i Dejës? | 13 |
| 1.2 Nevoja për një Plan Strategjik i Zhvillimit në Bashkinë Vau i Dejës | 13 |
| 1.3 Parimet dhe Objektivat mbi të cilat mbështetet Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Vau i Dejës | 14 |
| 1.4 Struktura e Planit Strategjik të Zhvillimit | 15 |
| 1.5 Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit | 16 |
| KAPITULLI II | |
| Përmbledhje e Profilit – Bashkia Vau i Dejës | 19 |
| 2.1 Pozicioni Gjeografik dhe Karakteristikat Natyrore | 19 |
| 2.2 Konteksti Rajonal | 21 |
| 2.3 Të Dhëna Historike | 22 |
| 2.4 Profili i Bashkisë | 23 |
| 2.4.1 Profili ekonomik i bashkisë Vau i Dejës | 23 |
| 2.4.2 Prioritetet në Zhvillimin Ekonomik | 24 |
| 2.4.3 Të dhëna financiare të Bashkisë Vau i Dejës | 24 |
| 2.4.4 Punësimi | 25 |
| 2.4.5 Shërbimet Publike | 25 |
| 2.4.6 Rrjeti i Ujësjellës Kanalizimeve | 26 |
| 2.4.7 Kanalizimet e ujërave të zeza | 26 |
| 2.4.8 Infrastruktura rrugore | 27 |
| 2.4.9 Transporti Publik | 28 |
| 2.4.10 Mbeturinat Urbane | 28 |
| 2.4.11 Varrezat Publike | 29 |
| 2.4.12 Zhvillimi social | 29 |
| 2.4.13 Popullsia | 30 |
| 2.4.14 Arsimi | 31 |
| 2.4.15 Aktivitetet sportive | 32 |
| 2.4.16 Zhvillimi dhe Integrimi Gjinator | 32 |

| | |
|-------------------------------------------------|-----------|
| 2.4.17 Shëndeti publik | 33 |
| 2.4.18 Struktura Hapësinore Urbano Rurale | 34 |
| 2.4.19 Strehimi | 35 |
| 2.4.20 Mjedisi i shëndetshëm | 36 |

KAPITULLI III

| | |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Zhvillimi i Ardhshëm i Propozuar i Bashkisë | 39 |
| 3.1 Vizioni i Zhvillimit Të Bashkisë Vau i Dejës | 39 |
| 3.2 Drejtimet e Zhvillimit sipas përcaktimeve të Grupit të Qytetarëve | 40 |
| 3.3 Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës | 40 |
| 3.4 Fushat e Ndërhyrjes | 41 |
| 3.4.1 Objektivi A. Zhvillimi ekonomik në Bashkinë Vau i Dejës | 41 |
| 3.4.2 Objektivi B. Përmirësimi i menaxhimit të territorëve në Bashkinë Vau i Dejës | 43 |
| 3.4.3 Objektivi C. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike | 52 |
| 3.4.4 Objektivi D. Qeverisja e Mirë Vendore | 55 |
| 3.4.5 Objektivi F. Rritja e Mundësive Financiare | 56 |

KAPITULL IV

| | |
|---------------------------------------------------------------------------------------|-----------|
| Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të propozuar për Bashkinë Vau i Dejës | 60 |
| 4.1 Ndërhyrjet Institucionale dhe Ligjore të Propozuara: | 60 |
| 4.2 Plani I Veprimit | 60 |
| 4.2.1 Plani i Veprimit për vitin 2008 | 60 |
| 4.2.2 Plani i Veprimit për vitin 2009 | 61 |
| 4.2.3 Plani i Veprimit për vitin 2010 | 63 |
| 4.2.4 Plani i Veprimit për vitin 2011 | 66 |
| 4.2.5 Plani i Veprimit për vitin 2012 | 69 |
| 4.2.6 Plani i Veprimit për vitin 2013 | 71 |
| 4.2.7 Plani i Veprimit për vitin 2014 | 73 |
| 4.3 Skema e Monitorimit dhe Treguesit Përkatës | 73 |

Fjala Përshëndetëse

Të dashur qytetarë të Bashkisë Vau i Dejës!

Prej tashmë një viti, administrata jonë është angazhuar në përgatitjen e Planit Strategjik të Zhvillimit i cili përbën edhe dokumentin kryesor udhërrëfyes për orientimin e zhvillimeve të ardhshme në Bashkinë Vau i Dejës. Në këtë iniciativë Bashkia ka gjetur mbështetjen e Intercooperation Albania, një organizatë zhvillimi zvicerane, e cila po jep asistencën e vet në Rajonin e Shkodrës.

Gjithashtu, në këtë sipërmarrje të rëndësishme është angazhuar Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, i cili ka një eksperiencë të gjerë në hartimin e dokumentëve të tillë në bashki dhe komuna të ndryshme në Shqipëri. Mund të them me bindje se bashkëpunimi me këto dy subjekte ka qenë një nga eksperiencat më të frytshme dhe produktive të Bashkisë sonë gjatë viteve të fundit!

Planit Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës është gjithashtu rezultat i angazhimit serioz të Grupit të Punës në Bashki, si dhe i Grupit të Përfaqësimit qytetar të cilët morën pjesë dhe dhanë kontributin e tyre të vlefshëm gjatë të gjithë procesit të përgatitjes së dokumentit. Vlen të theksohet në këtë aspekt, aftësitë moderuese të përfaqësuesve të Co-PLAN, të cilët arritën që të menaxhonin këtë proces punë gjithëpërfshirës.

Në mënyrë të veçantë dua të shpreh mirënjohjen time për angazhimin e të gjithë aktorëve të përmendur si dhe besimin tim se Planit Strategjik i Zhvillimit do të jetë një shtyllë e rëndësishme orientuese drejt hapësirave dhe mundësive të reja në të ardhmen në Bashkinë tonë!

Me respekt!

Gjon Marku
Kryetari i Bashkisë

Mirënjohje

Ky dokument është produkt i angazhimit të përbashkët të Bashkisë Vau i Dejës, dhe përkatësisht grupit të saj të punës, me ekspertët e Intercooperation Albania që operojnë në rajonin e Shkodrës në Veri të Shqipërisë, eksperteve të Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit si dhe me ndihmesën e çmuar të ekspertëve të kompanisë Urbaplan, Zvicër.

Për përgatitjen e këtij dokumenti, në mënyrë të veçantë duhet theksuar këmbëngulja dhe vizioni i kryetarit të Bashkisë Vau i Dejës, Z. Gjon Marku, i cili krijoi hapësirën e nevojshme administrative dhe institucionale për mbarëvajtjen e punës si dhe për përfshirjen e të gjithë aktorëve kryesorë vendore në këtë Bashki

Gjithashtu mirënjohje i dedikohet në këtë dokument komunitetit të Bashkisë Vau i Dejës, dhe përkatësisht grupit të përfaqësimit qytetar, i cili në mënyrë dinjitoze dha ndihmesën e çmuar për hartimin dhe finalizimin e këtij plani, nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në proces si dhe sugjerimeve, komenteve apo kritikave të vyera.

Së fundmi, por me një rëndësi të theksuar Grupi i Punës shpreh mirënjohje ndaj Intercooperation Albania për mbështetjen e tyre në këtë nisme si dhe ofrimin të eksperiencës së tyre unike.

Grupi i Punës në Bashkinë Vau i Dejës: Z. Ernest Paluku, nënkryetar i Bashkisë, Z. Salvator Gaci, shef i Zyrës së Urbanistikës, Zj Valjeta Nikaj, shefe e Zyrës së Financës, Z. Ndue Paluka, Sekretar i Këshillit Bashkiak

Grupi i Qytetarëve të Vaut të Dejës: për kontributin e tyre të vlefshëm dhe pjesëmarrjen aktive, pa lënë jashtë vëmendjes të gjithë mbështetjen e dhënë nga mbarë qytetaria dhe opinioni publik në bashkinë e Vau i Dejës.

Ekipi Co-PLAN: Z. Enton Derraj, Znj. Darina Kokona, Z. Dritan Shutina, Z. Florian Ravoniku, Znj. Elona Saro, Z. Indrit Faja

Intercooperation Albania: Z. Pascal Arnold, Znj. Valbona Karakaçi, Z. Aljon Koçkiq



Hyrje

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës u përgatit në kuadër të Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (DLDP), të zbatuar në Rajonin Verior të Shkodrës. Bashkia Vau i Dejës është një ndër tetë njësitë partnere të qeverisjes vendore përfituese të këtij programi, krahas Bashkive Shkodër, Pukë, Fushë-Arrëz, Koplík si dhe Komunave Velipojë, Dajç dhe Guri i Zi.

Programi DLDP synon të mbështesë bashkitë dhe komunat gjatë procesit të vazhdueshëm të decentralizimit të pushteteve vendore në Shqipëri. Ai përfshin mbështetjen për planifikimin strategjik të përdorimeve të tokës urbane dhe rurale, përmirësimin e shërbimeve publike, reformat administrative dhe ato të menaxhimit si dhe rritjen e komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve drejt një qeverisjeje lokale me të përgjegjshme dhe transparente. DLDP gjithashtu mbështet forcimin e bashkëpunimit interkomunor si dhe me institucionet në nivel rajonal (kryesisht Qarku) dhe kombëtarë. Programi financohet nga qeveria zvicerane dhe zbatohet nga Intercooperation, një fondacion po zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim.

Qëllimi i këtij dokumenti është pajisja e autoriteteve vendore me një dokument udhërrëfyes, i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit të ardhshëm të Bashkisë duke orientuar çështje si ato të zhvillimit ekonomik, ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen dhe kapacitetet e nevojshme të shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit, etj.

Duke u bazuar në situatën specifike të Bashkisë Vau i Dejës si dhe në nevojat e komuniteteve në Shqipërinë Veriore, metodologjia e përgatitjes së Strategjisë së Zhvillimit u strukturua së bashku me ekspertë dhe partnerë të ndryshëm të Bashkive dhe Komunave duke u fokusuar në:

- a) Një proces të hapur, pjesëmarrës dhe transparent, duke përfshirë aktorët kryesorë vendorë dhe rajonalë, për të siguruar miratimin e gjerë dhe pronësinë finale të këtij dokumenti strategjik të rëndësishëm
- b) Kombinimin e Planit me instrumenta të menaxhimit të territorit për të adresuar sa më mirë sfidat e autoriteteve vendore për ndërtimet informale si dhe një planifikimi urban dhe përdorimi të tokës sa më eficient
- c) Lidhjen dhe integrimin e planit të zhvillimit lokal me politikat dhe planet rajonale dhe kombëtare, duke siguruar kështu një strukturë koherente planifikimi.




Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës është përgatitur gjatë një procesi të hapur pjesëmarrjeje disamujore, i udhëhequr nga “grupi i punës” dhe “grupi i qytetarëve”, të përfshirë në një cikël seminaresh debatuuese dhe konsultative. Ekipi i përbashkët i punës përfshiu përfaqësues të administratës vendore të Bashkisë Vau i Dejës, Këshillit Vendor, kryepleq të fshatrave, grupe të ndryshme interesi lokal (biznesmenë, emigrantë, fermerë, etj), përfaqësues të Qarkut të Shkodrës përfaqësues të organizatave jo-fitimprurëse (OJF) apo organizatave me bazë komunitare (OBK), si dhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre si shoqëri civile në zonat përkatëse. Ekspertë nga organizatat e përmendura më sipër dhanë kontributin e tyre teknik në mbështetje të projektit.



Nxitja e pjesëmarrjes të komunitetit, bazuar në forma jodiskriminuese dhe paanshmëri në lidhje me moshën, gjininë, racën, etninë, përkatësinë fetare apo bindjet politike, i ka shërbyer qëllimit për të siguruar legjitimitet dhe konsensus ndërmjet paleve lidhur me Planin, afrimin e komunitetit në vendim-marrje, rritjen e nivelit të transparencës së autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të detyrave të veta administrative dhe shkallës së ndergjegjësimit mbi gamën e shqetësimeve dhe pritshmërive që mbart komuniteti vendas, të gjitha këto si elemente të rëndësishëm për një qeverisje të mirë.



Kapitulli I



1.1 Çfarë është dhe çfarë përfaqëson Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Vau i Dejës?

Një plan novator; për herë të parë në Bashkinë Vau i Dejës është hartuar dhe miratuar një Plan Strategjik Zhvillimi duke hapur kështu rrugën për një përjasje më të organizuar dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Një produkt i orientuar drejt procesit; duke përcaktuar axhendën e zhvillimit të zonës, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës i shërben rritjes së mirëqënies të të gjithë komunitetit. Plani identifikon një proces të tërë në të cilin angazhohen jo vetëm strukturat e administratës lokale të Bashkisë por edhe aktorët kryesorë, grupet e interesit dhe qytetarët e Bashkisë Vau i Dejës.

Një plan vizionar; në sajë të përfshirjes së komunitetit në procesin e përgatitjes së tij, Plani Strategjik i Zhvillimit orientohet sipas koncepteve vizionare të komunitetit në lidhje me zhvillimin. Duke qënë se në kontekstin shqiptar të zhvillimit dhe të planifikimit kanë munguar përjasjet vizionare që shpjegojnë se ku dhe si do të orientohen potencialet ekzistuese, Plani i propozuar i bashkëngjitet me një ekuilibër më të arrirë zhvillimit rajonal të Shkodrës, duke u koordinuar sipas të gjitha fushave përkatëse.

Një plan pragmatist; Plani Strategjik i Zhvillimit është konceptuar si një lloj kontrate aksionesh midis

autoriteteve vendore dhe qytetarëve e cila specifikon llojin, sasinë dhe formën e zhvillimit duke mbrojtur me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Për këtë arsye Plani është i fokusuar të ndërtojë një program pune me një plan veprimesh konkret, që synon të fillojë dhe të influencojë proceset e ardhshme të zhvillimit në Bashki. Plani adreson nevojat bazë, kërkesat dhe sfidat e qytetarëve, nëpërmjet shfrytëzimit racional të potencialeve dhe burimeve ekzistuese.

Një plan i përditësuar dhe realist; i kombinuar me instrumentët e menaxhimit të territorit, ky dokument do të rishikohet dhe përditësohet në mënyrë të rregullt. Instrumentat e menaxhimit të territorit (duke përfshirë edhe Planin e ri Rregullues të qytetit Vau i Dejës) si edhe foto imazhe të ndryshme që pasqyrojnë kushtet aktuale në vend dhe zhvillimin, do të shërbejnë për të lehtësuar procesin e menaxhimit të territorit në këtë Bashki.

Një plan të aprovuar ligjor dhe detyrues; duke u bazuar në Ligjin ekzistues të Qeverisjes Vendore në Shqipëri, Plani Strategjik i Zhvillimit (PSZH) e ka konsoliduar vlerën e tij ligjore dhe detyruese për zbatim që në momentin e miratimit nga Këshilli Vendor i Bashkisë Vau i Dejës.

1.2 Nevoja për një Plan Strategjik Zhvillimi Lokal në Bashkinë Vau i Dejës

Në kuadër të procesit të vazhdueshëm të decentralizimit në Shqipëri, detyrat dhe kompetencat e njësive vendore janë gradualisht duke u rritur dhe qartësuar. Në bazë të Ligjit Nr. 8652. "Mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore në Shqipëri", misioni kryesor i njësive vendore është të sjellë qeverisjen sa më pranë qytetarëve, nëpërmjet fuqizimit të vlerave si dhe respektimit të të drejtave qytetare. Promovimi i zhvillimit ekonomik lokal, furnizimi me shërbimet bazë publike, mbrojtja e mjedisit si dhe përmirësimi i kontrollit mbi territorin dhe proceset

e planifikimit urban janë ndër detyrat kryesore për çdo njësi vendore. Të gjitha këto kanë nevojë për një planifikim strategjik për të siguruar kështu një zhvillim koherent dhe të qëndrueshëm.

Në këtë mënyrë, Plani Strategjik i Zhvillimit plotëson këto kritere:

- Ai është një dokument që orienton veprimet e Bashkisë duke e mundur këtë të fundit që të veprojë sipas një vijimesie të qartë procesesh dhe aktiviteteve në vite.

- Plani i mundëson komunitetit lokal që të përpunojë një vizion të përgjithshëm për të ardhmen e njësisë vendore, duke përcaktuar në të njëjtën kohë edhe misionin e autoriteteve vendore.
- Plani është një instrument që propozon një seri projektesh dhe veprimesh, të cilat Bashkia mund ti adresojë në qeverinë qendrore apo në partnerë të tjerë financiarë si psh. agjencitë donatorë, për të siguruar kështu financime të vazhdueshme
- Ai është një instrument që vjen si rezultat i një procesi pjesëmarrës gjatë të cilit, qytetarët kanë qenë të mundur që të përcaktojnë nevojat e tyre si dhe prioritetet për veprim.
- Plani trajton të gjitha çështjet prioritare që shqetësojnë jetën e përditshme të qytetarëve të Bashkisë Vau i Dejës
- Plani është i njohur nga qytetarët dhe i lejon

autoriteteve të Bashkisë që të veprojnë në mënyre transparente në mbështetje të tyre.

- Plani është një dokument që lejon veprime efektive, duke përfshirë në vetvete një proces monitorues i cili mundëson rishikimin periodik të objektivave dhe veprimeve; vetë qytetarët janë të përfshirë në procesin e rishikimit.

Një shtysë tjetër e rëndësishme, në përforcim të nevojës për pajisjen e Bashkisë Vau i Dejës me një Plan Strategjik Zhvillimi erdhi gjithashtu edhe nga nismat, propozimet apo idetë e shprehura lidhur me Planin Strategjik të Rajonit të Shkodrës dhe më gjerë. Për këtë arsye, Plan analizon konkretisht këto ndikime të pritshme në zhvillimin e Vaut të Dejës dhe krijon kushtet e përshtatshme të bashkepunimit me to dhe përfitimit të ndërsjellë prej tyre, për të mbështetur objektivat më të gjera sociale, ekonomike dhe mjedisore të komunitetit.

1.3 Parimet dhe Objektivat mbi të cilat mbështetet Plani Strategjik i Zhvillimit për Bashkinë Vau i Dejës

Dokumenti i Planit Strategjik të Zhvillimit i Bashkisë Vau i Dejës mbështetet dhe ndjek parimet dhe objektivat si më poshtë vijon:

- **Strategjik**, plani përcakton fushat e veprimit afatgjatë si dhe ndërhyrjet konkrete të cilat adresojnë nevojat emergjente të popullsisë apo grupeve të ndryshme të interesit, në një mënyrë që të kombinojë gjithashtu edhe tendencat e zhvillimit në lidhje me të ardhmen e Bashkisë.
- **I thjeshtë dhe i kuptueshëm**, duke prezantuar propozime konkrete dhe të prekshme për administratën vendore dhe në tërësi për nivelin e vendimarrjes vendore. Po ashtu ky plan do të jetë i aksesueshëm nga banorët vendas, grupe të ndryshme interesi të popullsisë, sipërmarrjet private vendase me qëllim për të mundësuar njohjen dhe praktikën e propozimeve të dala në të gjitha fushat e veprimit që mbulohen nga administrata e Bashkisë Vau i Dejës.
- **Fleksibël**, plani krijon hapësira për ndryshime të mundshme të bazuara në kriteret e nevojave që mund të dalin si pasojë e situatave të ndryshme të paparishikuara, zhvillimeve të reja dhe përmirësimeve të vazhdueshme që do të dalin si rezultat i punës së pushtetit vendor përgjatë zbatimit. Pa dyshim këto ndryshime do të realizohen duke iu referuar edhe kërkesave apo nevojave specifike sipas grupeve përkatëse të interesit.
- **I arritshëm**, Plani Strategjik i Zhvillimit është hartuar duke u bazuar në mundësitë reale të Bashkisë Vau i Dejës si në kuptimin e këndvështrimin të burimeve njerëzore ashtu dhe ato financiare, ndërkohë pa munguar apo shmangur ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike të cilat edhe mund të shkojnë përtej kapaciteteve apo burimeve ekzistuese të Bashkisë.

- **Transparent**, në kuptimin se ky dokument në vetë llojin e tij është i hapur ndaj propozimeve të përfshira që kanë ardhur nga vetë komuniteti, biznesi apo grupe të tjera të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në Bashkinë e

Vaut të Dejës. Në këtë mënyrë Plani Strategjik i Zhvillimit nxit rritjen e besimit përkundrejt pushtetit vendor si dhe përgjegjshmërinë përgjatë kohës së zbatimit të saj.

1.4 Struktura e Planit Strategjik të Zhvillimit

Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës është organizuar në katër kapituj kryesorë duke zbatuar si më poshtë vijon:

KAPITULLI I PARË na jep një hyrje të kontekstit, rëndësisë dhe koncepteve kryesore mbi të cilat është bazuar dhe hartimi i PSZH.

KAPITULLI I DYTË, është një pasqyrë reale e situatës aktuale dhe profilit të Bashkisë Vau i Dejës, bazuar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe informacionit ekzistues duke e paraqitur atë në këndvështrimin territorial, urban, social – ekonomik si dhe mjedisor. Gjithashtu, në këtë kapitull evidentohet potencialet, sfidat dhe tendencat kryesore të zhvillimit në të ardhmen.

KAPITULLI I TRETË vazhdon me objektivat e përgjithshëm në të ardhmen, duke u bazuar në

vizionin dhe drejtimet strategjike të zhvillimit në 5 fusha prioritare. Të gjitha këto fusha ndiqen nga një plan i detajuar në nivel nismash dhe ndërhyrjesh konkrete me fokus zhvillimin ekonomik dhe social, menaxhimin e territorit, shërbimet publike dhe infrastrukturën përkatëse, qeverisjen e mirë me pjesëmarrje, dhe së fundmi po shumë e rëndësishme rritjen e të burimeve financiare të nevojshme dhe të kërkua për zbatimin e mëtejshëm të planit.

KAPITULLI I KATËRT përcakton detajet që burojnë nga kapitulli i tretë duke i përkthyer ato në plane konkrete veprimi të cilat do të zbatohen vit pas viti, bazuar në kriteret e qarta kohore dhe përgjegjësitë konkrete. Në fund të tij paraqitet struktura e nevojshme ligjore dhe institucionale si dhe konteksti dhe kuadri kohor i procesit të monitorim vlerësimit.

Pamje të procesit të përgatitjes së Planit Strategjik të Zhvillimit në Bashkinë Vau i Dejës



1.5 Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit

Është tepër e rëndësishëm për administratën vendore në Bashkinë Vau i Dejës që të ketë autoritetin e plotë dhe pronësinë mbi këtë dokument strategjik të propozuar, duke lehtësuar kështu zbatimin e ndërhyrjeve të ardhshme të propozuara në planin e veprimit.

Që në fillimet e konceptimit të metodologjisë së dokumentit, të bazuar në procesin me pjesëmarrje, dhe në trajtimin e përmbajtjes së tij në formën e një dokumenti udhërrëfyes, aktoret vendorë në Bashkinë e Vaut të Dejës u konsideruan si partnerë të rëndësishëm për të garantuar zbatimin e suksesshëm dhe transparent të Planit Strategjik të Zhvillimit.

Pa dyshim që administrata e Bashkisë Vau i Dejës mbetet aktori kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti, në linjë me procesin periodik të planifikimit dhe të buxhetimit. Të tjerë aktore të

përfshirë në proces do të japin ndihmesën e tyre në monitorimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të planit.

Ndërkohë që vizioni i shprehur apo objektivat strategjike i përkasin një afati kohor në terma më të gjata, plani i veprimeve të përshkruara në dokument është më konçiz dhe i referohet një periudhe më të shkurter kohore, me një mundësi për shtrirje në të ardhmen.

Nga ana tjetër, për shkak të tranzicionit në vazhdim, në Shqipëri priten ndryshime të shumta, që do të reflektohen padyshim edhe në Rajonin e Shkodrës dhe në Bashkinë Vau i Dejës. Për këtë arsye rishikimi i Planit Strategjik të Zhvillimit duhet të jetë një subjekt reflektimi i vazhdueshëm. Plani duhet të rishikohet në mënyrë periodike duke adoptuar dhe integruar ndryshimet e shkaktuara nga zhvillimet apo tendencat e reja të tranzicionit në Shqipëri.



Kapitulli II




Përmbledhje e Profilin – Bashkia Vau i Dejës

| No. | Emri | Vlera / karakteristika |
|--------------------------------------------|----------------------------------------------|----------------------------------------------------------|
| 1 | Statusi Ligjor dhe Administrativ | Bashki |
| 2 | Vendndodhja | Qarku Shkodër |
| 3 | Sipërfaqja totale | 31 km ² |
| 4 | Numri i qyteteve | 1 |
| 5 | Numri i fshatrave | 8 |
| 6 | Numri i banorëve | 12, 345 |
| 7 | Numri i familjeve | 3330 |
| 8 | Popullsia në gjendje fizike pune | 50% |
| 9 | Buxheti Vjetor - 2008 | 41,056,000 Lek |
| 10 | Të Ardhurat Lokale të Pritshme - 2008 | 17,000,000 Lek |
| 11 | Numri i Bizneseve Private | 105 |
| 12 | Niveli i Papunësisë | 1600 (33% e forcës së aftë) |
| 13 | Numri i të punësuarve në shtet | 280 |
| 14 | Numri i të punësuarve në sektorin privat | 145 |
| 15 | Niveli i emigracionit | 37% |
| 16 | Gjatësia totale e rrugëve | 63 km |
| 17 | Numri i Ndërmarrjeve Publike | 1 |
| 18 | Numri i rrjeteve të Ujësjetllës Kanalizimeve | 1 |
| 19 | Numri i të punësuarve në Bashki | 32 |
| 20 | Numri i institucioneve parashkollorë | 5 |
| 21 | Numri i shkollave fillore - nëntëvjeçare | 9 |
| 22 | Numri i shkollave të mesme | 2 |
| 23 | Numri total i nxënësve | 2116 |
| 24 | Numri i qendrave shëndetësore | 5 |
| 25 | Numri i spitaleve | 2 |
| 26 | Numri i qendrave të keshillimit | 0 |
| 27 | Numri i qendrave për të moshuar | 0 |
| 28 | Aktivitetet kryesore ekonomike | Hydrocentrali Vau i Dejës |
| | | Bujqësi |
| | | Dyqane dhe njësi tregëtare |
| | | Njësi shërbimi |
| 29 | Dokumenta zhvillimi dhe strategji | Plani Rregullues i Qytetit |
| | | Strategjia e Zhvillimit Rajonal |
| 30 | Nevojat kryesore në Infrastrukturë | Përmirësimi i rrjeteve të ujësjetllës kanalizimeve |
| | | Ndërtimi i pikës së trajtimit të ujerave të zeza |
| | | Ndërtimi i By Passit të Qytetit |
| | | Përmirësimi i rrjetit rrugor të brendshëm të qytetit |
| | | Ndërtimi i Spitalit të Ri Qytetit |
| | | Ndërtimi i pikës inxhinierike të depozitimit të mbetjeve |
| | | Ndërtimi i pesë shkollave të reja |
| Ndërtimi i pritave mbrojtëse të lumit Drin | | |

2.1 Pozicioni Gjeografik dhe Karakteristikat Natyrore

Bashkia e Vaut të Dejës përbëhet nga qyteti i Vaut të Dejës si dhe tetë fshatra të tjerë, përkatësisht Kaç, Naraç, Mjedë, Karmë, Gomsiqe, Spathar, Dush dhe Shelqet. Ajo shtrihet në Jug lindje të qytetit Shkodër

dhe kufizohet në Jug-Lindje dhe Jug-Perëndim në Komunën Hajmël, në Veriperëndim me Komunën Guri i Zi, në Lindje dhe Verilindje me Rrethin e Pukës. Ka një sipërfaqe totale prej 31 km² nga të cilat vetëm



4,33 km² janë urbane. Gjithashtu, Bashkia disponon rreth 1141 Ha tokë bujqësore, e cila shtrihet në pjesën perëndimore dhe jugperëndimore të territorit të Bashkisë.

Bashkia e Vaut të Dejës numëron një popullsi prej 12.345 banorë, nga të cilët 6.147 janë banorë të zonave urbane dhe 6.198 banorë të zonave rurale.

Sipërfaqja në të cilën shtrihet Bashkia Vau i Dejës karakterizohet nga një larmi karakteristikash topografike, gjeologjike, klimaterike dhe hidrologjike për shkak të ndryshimit të relievit

dhe kalimit gradual nga masivi kodrinor malor në lindje, në fushat e gjera të krahinës së Zadrimës në perëndim.

E veçantë për këtë Bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, një pjesë e konsiderueshme e të cilit gjendet brenda territorit administrativ të Bashkisë; lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shkëputet nga lumi i parë, rreth 1km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës.

2.2 Konteksti Rajonal

E shtrirë në pjesën juglindore të rajonit të Shkodrës, Bashkia e Vaut të Dejës është pjesë e ndryshimeve të pritshme që parashikohen në mënyrë analitike në Strategjinë Rajonale për Zhvillim të Qarkut Shkodër. Pozicionimi i bashkisë përgjatë rrugës Shkodër Pukë – Kosovë e ka identifikuar Vaun e Dejës si një portë hyrëse në drejtim të Kosovës, duke identifikuar nevojën për të studiuar dhe trajtuar korridorin rrugor kryesor Mjedë Vau i Dejës, si dhe ristrukturimin urban të territoreve të banuara në këtë segment.

Ndërtimi i autostradës Durrës – Kukës – Morinë, i cili do të shkurtojë ndjeshëm kohën e transportit midis zonës Verilindore dhe Kosovës me korridorin qendror të zhvillimit Tiranë Durrës, do të bëjë që të humbasë deri diku rëndësia si dhe ngarkesa e

Skema e korridoreve të rëndësishëm rrugore, sipas Strategjisë së Zhvillimit të Rajonit të Shkodrës.




Figure 3.1 CONCEPT PLAN

trafikut përgjatë rrugës Shkodër - Pukë - Kukës.

Ky problem i evidentuar në Strategjinë Rajonale për Zhvillimin e Qarkut Shkodër, i ngritur si shqetësim nga autoritetet lokale të Bashkisë Vau i Dejës si dhe i manifestuar nga qytetarët e kësaj zone, është adresuar me kujdes në Planin e propozuar me synimin për të krijuar një kontekst vizionar në lidhje me zhvillimin e Vaut të Dejës, si pjesë integrale e rajonit verior të Shqipërisë.

Ekzistenca e industrisë energjitike, potenciali ekzistues energjitik i ujit dhe i erës mund të vendosen në një kontekst të tillë përdorimi dhe menaxhimi në favor të rritjes ekonomike dhe zhvillimit të bashkisë Vau i Dejës por edhe të gjithë Rajonit të Shkodrës. Një komponent tjetër i rëndësishëm në Strategjinë Rajonale Shkodër Lezhë është krijimi dhe konsolidimi i një Rajoni Policentrik, duke u fokusuar në këtë mënyrë jo vetëm në Shkodër, por edhe në qytezat satelite, si Vau i Dejës, Kopliku, Bushati apo në qendrat e tjera më të vogla. Për këtë arsye është e nevojshme që qyteza të tilla, në rastin konkret, Vau i Dejës, të eksplorojnë mundësitë më të mira për të thithur një pjesë të konsiderueshme të fluksit të migrimit nga zonat e thella në lindje drejt fushëgropës së Shkodrës. Në këtë mënyrë, do të tentohet kalimi drejt zhvillimit të “tregut” të popullsisë, dhe rrjedhimisht të krahut të punës në këtë bashki, element ky vendimtar në zhvillimin ekonomik dhe social të një qendre të banuar.

E parë në këtë kontekst afërsia e bashkisë dhe e qytetit të Vaut të Dejës me qytetin e Shkodrës konsiderohet si një potencial shumë e mirë për akomodimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, në shërbim të qendrës urbane të rajonit, duke vënë në shfrytëzim sa më eficient burimet natyrore dhe njerëzore të Bashkisë Vau i Dejës.

Përveç aktiviteteve ekonomike të industrisë së lehtë, Strategjia Shkodër Lezhë e vë theksin gjithashtu edhe në zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të agrobiznesit në të gjithë zonën fushore, duke u bazuar në potencialet që natyrorë dhe njerëzore që disponon. Bashkia Vau i Dejës, disponon një fond të konsiderueshëm tokash bujqësore nën ujë,

shfrytëzimi i të cilave duhet të trajtohet në mënyrë të integruar nëpërmjet riorganizimit të fermave prodhuese, mbrojtjes së tokës bujqësore nga ndërtimet ilegale si dhe rritjes së produktivitetit të saj. Në këtë mënyrë vetë Bashkia do të kishte mundësi më shumë për rritjen e saj ekonomike dhe si rrjedhim rritjen e nivelit të jetesës.

Një tjetër komponent që duhet marrë në konsideratë në lidhje me propozimet e Strategjisë

së Zhvillimit Shkodër Lezhe është zhvillimi i turizmit natyror dhe turizmit të përkrahur. Në rastin e Bashkisë Vau i Dejës, është e rëndësishme të merret në konsideratë potenciali që kjo zonë ka, duke pasur parasysh zhvillimin e turizmit ujqor, apo edhe agroturizmit. Propozimet në Strategjinë lokale në Vaun e Dejës duhet të trajtojnë pikërisht mundësinë e shfrytëzimit të këtyre potencialeve, duke krijuar kështu oportunitete të tjera për rritje dhe zhvillim.

2.3 Të Dhëna Historike

Historiku i qytetit me emrin sot Vau-Dejës nis me vendbanimin e vjetër të Danjës, i themeluar rreth vitit 1127. Ekzistenca e trojeve të vjetra të kështjellës dhe kishës së Shën Markut, e cila është ndër më të vjetrat në Ballkan, ende sot mbartin vlera arkeologjike për studime historike. Sipas historianëve në këtë zonë organizohej çdo vit një panair i madh në të cilën merrnin pjesë banorë nga krahinës së Zadrimës.

Në majën që ndodhet në kodrën e Danjës, i mbiquajtur Mali i Shën Markut, ndodhen edhe

rrenojat e një kishe që mban të njëjtin emër. Nga emri i kësaj kalaje mori emrin e gjithë zona. Të dhënat arkeologjike flasin për një vendbanim të zhvilluar mesjetar.

Kalaja e Danjës sot Deja ka qenë një qendër e zhvilluar dhe me ndikim të madh në të gjithë zonën e Zadrimës. Në këtë kala është bërë lufta me e madhe me Venedikasit ku është vrrarë Lekë Zaharia, Ai është varrosur në kishën e Shën Mrisë në Vaun e Dejës e cila është tashmë e rindërtuar. Me vdekjen e Lek Zaharisë kalaja u pushtua nga Venecianët, të



cilët më pas u larguan nën presionin ushtarak të Gjergj Kastriot Skënderbeut. Mbas rënies së kalasë së Dejës një pjesë e mirë e popullsisë emigroi drejt Italisë.

Kalaja e Shurdhahut

Kalaja e Shurdhahut me muret e saj të rrenuara dhe me apsidet e shave, që shihen ende në këmbë edhe sot e kësaj dite, u pat rënë në sy edhe dijetarëve që vizituan Shqipërinë veriore. J.G.v, Hahni dhe me pas A.Degranti, Th.Ipeni dhe P. Treger në shënimet e tyre japin përshkrimin gjeografik të vendit dhe përmendin muret rrethuese e rrenojat e godinave të ndyshme që shihen Brenda në Kala Ipeni vinte

në dukje dhe teknikën primitive të ndërtimeve kurse Tregeri identifikoi katër varre karakteristike të kohës.

Gërmimet e para arkeologjike në Kalanë e Shurllahut filluan në vitin 1965 në qafën që lidh kodrën e kalasë me malin fqinj të margjeles, ku P.Tregeri kishte zbuluar katër varret. Ata vazhduan edhe gjatë viteve 1967-1970 duke u përqëndruar Brenda kalasë. Varret e para në nekropod dhanë një inventar arkeologjik të një tipi të njohur si fibula, unaza, temthore, sopata etj të cilat nuk ndryshojne nga ata që janë zbuluar në nekropolet e kalasë së Dalmaces.

2.4. Profili i Bashkisë

2.4.1 Profili ekonomik i Bashkisë Vau i Dejës

Para viteve 90, shumica e banorëve në Vaun e Dejës punonin në Hidrocentral, në Fabriken e Përpunimit dhe Pasurimit të bakrit si dhe në kooperativat bujqësore. Ndërkohë që zhvillimi ekonomik aktual mbështetet kryesisht në aktivitetet e vogla ekonomike si shërbime dhe tregëti, të cilat janë të pozicionuara kryesisht në qytetin Vau i Dejës si dhe përgjatë rrugës kryesore kombëtare Shkodër Pukë. Aktualisht, në territorin e kësaj Bashkie janë të regjistruara këto aktivitete ekonomike:

| Aktivitete ekonomike | % |
|----------------------------------------------|----------|
| Njësi tregëtare | 87% |
| Njësi prodhimi dhe përpunimi | 6% |
| Njësi shërbimi | 7% |
| Numri total i aktiviteteve private ekonomike | 105 |

Përveç aktiviteteve të vogla prodhuese, përpunuese dhe tregëtare, në pjesën fushore të territorit të Bashkisë Vau i Dejës, dhe pikërisht në fshatrat Mjedë, Naraç, Kaç funksionojnë aktivitete të vogla prodhuese bujqësore dhe blegtorale. Për shkak të copëzimit të tokës bujqësore si pasojë e reformës

së pronësise ne fillim të viteve 90 (Ligji 7501), si dhe mungesës së një sistemi të mirëfilltë informacioni për shfrytëzimin e tokës, administrata e Bashkise nuk disponon të dhëna lidhur me sipërfaqen reale të tokës bujqësore që punohet, apo për numrin e ekonomive bujqësore të krijuara. Produktet bujqësore janë kryesisht drithërat si dhe foragjerët për blegtorinë. Aktualisht Bashkia e Vaut të Dejës disponon 1141 Ha tokë bujqësore me kapacitete prodhuese të ndryshme.

Pas viteve 90, për pasojë të rifutjes në shfrytëzim të ekonomive private fermerë, ka një rritje të numrit të bagëtive në të gjithë territorin. Aktualisht, në Bashkinë Vau i Dejës numërohen 1,350 bagëti të trasha dhe 7,345 bagëti të imeta. Gjithashtu në këtë zonë funksionojnë edhe 8 baxho të cilat shfrytëzojnë prodhimet blegtorale të zonës. Prodhimet shiten në tregun lokal ndërsa një pjesë e tyre tregëtohen në qytetin e Shkodrës. Aktualisht Bashkia nuk ka një vend të posaçëm për grumbullimin, përpunimin dhe tregëtimin e produkteve bujqësore të vetat.

Origjina e të ardhurave për popullsinë lokale në Bashkinë Vau i Dejës jepen të shprehura si më poshtë:

| Origjina | % |
|---------------------------------------------------------|------|
| <i>Biznesi privat (treg,artizanat,blegtori,bujqësi)</i> | ≈50% |
| <i>Nga punësimi në Institucionet shtetërore</i> | ≈5% |
| <i>Nga emigracioni</i> | ≈35% |
| <i>Nga ndihma ekonomike</i> | ≈10% |

Sipas të dhënave të administratës së Bashkisë rreth 1/3 e popullsisë trajtohet me ndihmë ekonomike.



2.4.2 Prioritetet në Zhvillimin Ekonomik

Gjatë përgatitjes së Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës, Grupi i Qytetarëve, pjesëmarrës në këtë proces kanë evidentuar këto mundësi për zhvillimin e ardhshëm ekonomik

- *Rritja e mundësive të punësimit të banoreve nëpërmjet stimulimit të biznesit ekzistues, prodhimit artizanal dhe në vazhdimësi prodhimit të vogël industrial.*
- *Rritja e investimeve të huaja në territorin e Bashkisë Vau i Dejës*
- *Fuqizimi i sektorit të pylltarisë nëpërmjet iniciativave për pyllëzimin e sipërfaqeve të mëdha kodrinore që disponon Bashkia.*
- *Rritja e të ardhurave lokale nga taksat dhe tarifat e shërbimeve.*
- *Stimulimi dhe zhvillimi i turizmit natyror dhe në veçanti atë liqenor.*

2.4.3 Të dhëna financiare të Bashkisë Vau i Dejës

Në tabelën më poshtë paraqitet grafiku i granteve vjetore nga ana e qeverisë qendrore për Bashkinë Vau i Dejës.

Transferta financiare nga qeveria qendrore për Bashkinë Vau i Dejës (mijë lekë)

| Viti | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|--------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Granti | 26,094 | 32,345 | 35,399 | 40,448 | 41,056 |

Të ardhurat nga taksat vendore në Bashkinë Vau i Dejës janë në një gjendje mesatare. Kjo shpjegohet pjesërisht për faktin se egzistojnë pak aktivitete ekonomike të taksueshme, si dhe një pjesë e mirë e të ardhurave nuk taksohen (sidomos në rastin e aktiviteteve bujqësore).

| Viti | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 |
|-------------|-------|--------|--------|--------|--------|
| Të ardhurat | 9,000 | 11,000 | 13,000 | 15,000 | 17,000 |

Në sajë të ecurisë së financimit qeveritar për këtë Bashki si dhe nga diskutimet lidhur me mundësinë e rritjes së të ardhurave lokale nga taksat dhe shërbimet në Bashkinë Vau i Dejës është identifikuar një prognozë si në tabelën më poshtë.

| Viti | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 |
|---------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Buxheti | 58,000 | 61,000 | 64,000 | 70,000 | 75,000 |

2.4.4 Punësimi

Mosha 18-40 vjeç që i përket moshës aktive përbën rreth 35% të popullsisë në qytet dhe 31% të popullsisë fshatare. Nga këto 41% janë të papunë për qytetin dhe 36% për fshatin. Ndërkohe, niveli i papunësisë tek femrat është 43% në qytet si dhe 34% në fshat.

Në popullsinë urbane numërohen rreth 880 të papunë nga të cilët 418 janë meshkuj dhe 462 janë femra ndërsa në popullsinë rurale evidentohen 720 të papunë, nga të cilët 295 janë meshkuj dhe 425 janë femra. Në total Bashkia numëron rreth 1.600 të papunë në grup-moshën 18-40 vjeç.

Edhe pse shifrat nuk janë shumë të përditësuara situata në lidhje me mundësitë reale për punësim nuk janë në nivelin e përmbushjes së nevojave qytetare.

Reflektimi ndaj shifrës së lartë të emigracionit (me rreth 15 % të popullsisë së përgjithshme), tregon jo vetëm nivelin e ulët të punësimit në vend dhe detyrimin për tu larguar me qëllim sigurimin e të ardhurave, por në të njëjtën kohë shërben për të kuptuar se si për popullsinë urbane ashtu dhe atë rurale të ardhurat nga emigracioni zënë një peshë të konsiderueshme për përballimin e jetesës dhe mundësive për investime të vogla, kryesisht në sektorin e shërbimeve.

Ndërkohë, një pjesë e mirë e popullsisë në zonën urbane i siguron të ardhurat kryesisht nga punësimi në institucionet shtetërore (262 persona). Në lidhje me popullsinë në zonat rurale, identifikimi i të punësuarve është më i vështirë në shifra

2.4.5 Shërbimet Publike

Për sa i përket shërbimeve publike Bashkia Vau i Dejës në nivelin e njësisë së qeverisjes vendore, është përgjegjëse si më poshtë vijon:

- arsimit parashkollor – administrimi dhe mirëmbajtja e kopshteve dhe çerdheve;
- kujdesi shëndetësor – mirëmbajtja e ndërtesave;
- furnizimi me ujë dhe kanalizimet e ujërave të zeza;

- administrimi dhe planifikimi i territorit;
- ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve të brendshme;
- transporti publik – liçencimi dhe monitorimi i shërbimit;
- grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave urbane;
- mirëmbajtja e zonave të gjelbra;
- kultura – organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i vlerave lokale dhe traditave;

- administrimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit publik;
- dekori i qytetit;
- varrezat publike;
- administrimi dhe mirëmbajtja e ambienteve sportive
- shërbimet sociale

Në të njëjtën kohë disa prej këtyre funksioneve janë të përbashkëta si psh:

- arsimit parashkollor dhe parauniversitar – qeverisja qendrore është përgjegjëse për administrimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve, ndërkohe që sistemi i mësimdhënies është nën përgjegjësinë e ministrisë dhe drejtorisë rajonale.
- Shërbimi shëndetësor, si dhe shëndeti publik
- Shërbimet sociale dhe këshillimi
- Mbrojtja e mjedisit
- Rendi publik



2.4.6 Rrjeti i Ujësjellës Kanalizimeve

Me Vendim të Këshillit të Ministrave, Ujësjellësi i qytetit i ka kaluar në përgjegjësi të Bashkisë Vau i Dejës. Aktualisht në territorin e Bashkisë funksionon vetëm një rrjet ujësjellësi që është ai që furnizon qytetin e Vaut të Dejës, ndërkohë që të gjitha fshatrat furnizohen nga puset private. Rrjeti i ujesjellesit të qytetit është ndërtuar në vitin 1967 dhe mbulon vetëm një pjesë të territorit të qytetit, ndërkohë që një pjesë e mirë e tij furnizohen me ujë nga puset private.

Qyteti furnizohet me uje nga nga dy stacione pompimi. Qyteti i Vaut të Dejës disponon vetëm një depo uji me kapacitet 500 m3. Kjo depo është rikonstruktuar gjatë viteve 90. Problematike mbetet

gjithsesi mungesa e një sistemi të filtrimit të ujërave. Pas viteve 2000 rrjeti i ujesjellesit të qytetit i është nënshtruar një ndërhyrje rehabilituese me një vlerë prej 22,000,000 Lek. Megjithë investimin e kryer Ndërmarrja e Ujësjellësit nuk ka kapacitete të mjaftueshme për furnizimin me uje të të gjithë territorit të qytetit. Është fakt, që pjesa jugore e qytetit, Lagjja Kapedan, nuk furnizohet me ujë nga rrjeti i ujësjellësit.

Aktualisht qyteti ka ujë me ndërprerje. Nga të dhënat e marra në Bashki dhe në ndërmarrjen e ujesjellesit, rezulton që qyteti të ketë vetëm 6 ore ujë në ditë, në periudhën Qershor Shtator si dhe 8 orë në periudhën Tetor Maj.

2.4.7 Kanalizimet e ujërave të zeza

Vetëm një pjesë e vogël e qytetit Vau i Dejës disponon linja të kanalizimeve të ujërave të zeza. Kjo është zona e pallateve në pjesën perëndimore të qytetit, ndërkohe që të gjitha zonat e tjera nuk disponojnë

këtë lloj rrjeti. Si qyteti ashtu edhe fshatrat e tjerë të Bashkisë nuk kanë pika për pastrimin dhe filtrimin e ujërave të zeza. Në pjesën e qytetit ato përfundojnë në lumin Drin ndërkohë që në zonat rurale ujërat

e zeza përfundojnë Lumin Gjadër si dhe në gropat septike jo inxhinierike, të cilat përbëjnë një problem më vete po të marrim në konsideratë përdorimin në të njëjtën kohë të puseve për ujë nga ana e

banorëve. Ndërkohë ujërat e bardha shkarkohen lirshëm në përroin që kalon mospërmasë qytetit duke përfunduar kështu në Lumin Gjadër.

2.4.8 Infrastruktura rrugore

Në territorin e Bashkisë ka rreth 63 km rrugë; ndër këto vetëm 2/3 e tyre janë të asfaltuara. Për shkak të shtrirjes gjeografike, aksi kryesor më me rëndësi në territorin e Bashkisë Vau i Dejës është aksi rrugor rajonal Shkodër-Pukë. Kjo është edhe arteria kryesore me të cilën lidhen të gjitha rrugët e brendshme të fshatrave të Bashkisë. Deri në kryqëzimin me hekurudhën Tiranë-Shkodër rruga është në një gjendje të mirë teknike dhe fizike si dhe ka një profil tërthor prej 9 m. Megjithëse gjatë të gjithë këtij aksi janë të evidentuara shumë ndërtime me funksion rezidencial si dhe shërbime, profili i rrugës nuk ka trotuare duke përbërë një rrezik për jetën e banorëve të zonës.

Pas kryqëzimit me hekurudhën, dhe në drejtim të Mjedës, qytetit Vau i Dejës dhe me tej, në drejtim të Pukës, rruga është e asfaltuar por me dëmtime të shumta. Kjo është edhe pjesa me e shfrytëzuar e këtij aksi rrugor sidomos gjatë segmentit të Mjedës apo edhe segmentit përgjatë qendrës së qytetit. Rrugët e brendshme të fshatrave janë në një gjendje

relativisht të mirë, duke përfshirë Këto janë rrugët që lidhin fshatin Shelqet, Kaç dhe Naraç, të cilat janë asfaltuar së fundmi. Në sajë të përcaktimeve ligjore, Bashkia Vau i Dejës është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme (komunale) ndërkohë që aksi kryesor Shkodër-Pukë mirëmbahet me fondet e buxhetit të shtetit. Problem mbeten rrugët rajonale, të cilat mirëmbahen nga Qarku Shkodër.

Një nga ndërhyrjet më të rëndësishme të evidentuara nga Bashkia Vau i Dejës është ndërtimi i një By-Pass-i në jug të qytetit të Vaut të Dejës, qëllimi kryesor i të cilës është shmangia e trafikut të rëndë nga rruga kryesore e qytetit. Ky propozim është marrë në konsideratë në procesin e përgatitjes së Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Vaut të Dejës.

Në lidhje me infrastrukturën rrugore në Bashkinë Vau i Dejës, në raportin e UNDP-së ***“Nxitja e Zhvillimit Rajonal Nëpërmjet Objektivave të Mijëvjeçarit”***,



për rajonin e Shkodrës, është parashikuar lidhja e rajonin verilindor të vendit me Kosovën, e cila nënkupton në vetvete këto veprime:

1. ndërtimin e korridorit Mjedë-Morinë-Gjakovë në nivelin e një rruge të kategorisë së parë. Kjo rrugë e shkurton rreth 2 herë largësinë

Prishtinë-Ulqin, nëpërmjet të ciles kalon fluksi i turistëve por jo vetëm nga Kosova.

2. rehabilitimin e rrugës Mjedë-Pukë, e cila do të mund të shkurtojë rrugën për në Tiranë dhe në të njëjtën kohë rrit mundësitë për telekomunikacion më të mirë në lidhje me zhvillimin e turizmit brenda për brenda.

2.4.9 Transporti Publik

Aktualisht në Bashkinë e Vaut të Dejës është në funksionim linja transporti autobuzi, e mundur nga një shoqëri private e liçencuar. Kjo linjë mbulon vetëm rrugën Shkodër-Vau i Dejës. Ndërkohë, përgjatë rrugës kryesore Shkodër-Pukë funksionojnë edhe linjat e transportit të Kukësit, Fushë Arrezi dhe të Pukës, por ato kanë një frekuencë relativisht të ulët. Gjithashtu transporti sigurohet edhe nga furgonat private. Në Bashkinë Vau i Dejës funksionojnë aktualisht 12 furgona të liçencuar

dhe 16 taksi. Problematik mbetet transporti publik në fshatrat Kaç, Naraç si dhe në zonat e banuara në pjesën kodrinore dhe malore në lindje të Bashkisë. Vetë qyteti i Vaut të Dejës nuk disponon stacion të mirëfilltë transporti publik, ndërkohë që furgonat për pasagjerë parkohen përgjatë rrugës kryesore të qytetit. Përgjatë aksit kryesor Shkodër-Pukë, në zonën e Bashkisë së Vaut të Dejës, mbetet problem mungesa e stacioneve të qëndrimit për pasagjerët, gjë që përbën rrezik për këta të fundit.

2.4.10 Mbeturinat Urbane

Bashkia e Vaut të Dejës ka bërë disa përpjekje në drejtim të përmirësimit dhe funksionimit të sistemit të administrimit të mbeturinave urbane. Aktualisht që prej vitit 2006 është hartuar dhe vënë në zbatim plani i veprimit për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave urbane të qytetit. Ky shërbim si dhe pastrimi i rrugëve kryhet nëpërmjet shoqëri private të kontraktuar. Situata aktuale paraqet një mbulim të këtij shërbimi vetëm në 70% të territorit të qytetit, ndërkohë 30% e tij realizohet sipas nevojave në kushte të caktuara. Për këtë janë përcaktuar 65 pika grumbullimi që janë ekzistuese, nga të cilat vetëm 25 janë të pajisur me kazane mbeturinash. Shërbimi i pastrimit të rrugëve ndërkohë realizohet vetëm përgjatë rrugës kryesore të qytetit. Duhet përmendur ndërkohë që mungon një shërbim grumbullimi dhe depozitimi të mbeturinave urbane në fshatrat. Shumë problematike është mungesa e këtij shërbimi në fshatin Mjedë, ku pjesa më e madhe e mbeturinave hidhen në kanalet ujitëse. Si dhe në lumin Drin.

Problem i mprehtë për Bashkinë e Vaut të Dejës është venddepozitimi i mbeturinave, mungesa e të

cilit ka shkaktuar dhe vazhdon të krijojë probleme të ndotjes së mjedisit duke qenë se vendi aktual ku ato depozitohen është përgjatë rrugës nacionale. Degradimin mjedisor e shtojnë në mënyrë të ndjeshme pamundësia e mirëmbajtjes dhe kujdesit të vazhdueshëm jo vetëm nga ana e autoriteteve vendore, por dhe shkalla e ndërgjegjësimit të banorëve, të cilët të detyruar nga aroma e keqe, papastërtitë dhe ndotja e vendeve ku kullosin bagëtitë mendojnë të zgjidhin problemin në rrugën më të shkurtër, djegien e tyre në mjedis të hapur.

Ky fenomen, i cili rëndom gjykohet si zgjidhje e shpejtë krijon ndotje të lartë të ajrit, probleme të shëndetit në frymëmarrje, shpërndarjen e mbeturinave që nuk arrijnë të digjen apo hirin e tyre në masë më të gjerë, por duke mos lënë mënjandë ndotjen estetike të krijuar për të gjithë ata që udhëtojnë përgjatë rrugës kryesore, e cila jo vetëm është rruga hyrëse për në qytet por edhe për kalimin në zona të tjera përtej Vaut të Dejës. Në këtë gjendje, jo vetëm rrezikohet më tej shtrirja e pakontrolluar e tyre dhe rëndohen pasojat në shëndetin publik për të ardhmen, por zbehet edhe

imazhi për zonën në kuptimin e vlerave ekzistuese për turizëm.

Për zgjidhjen e këtij problemi është parashtruar mundësia e një venddepozitimi sanitar rajonal



Foto të mbetjeve urbane përgjatë rrugës kryesore në Vau i Dejës si dhe në kanalet e kullimit

(landfilli) në Bushat, nga i cili të mund përfitojnë të paktën disa njësi qeverisjeje vendore, Shkodra, Guri i Zi, Vau-Dejës dhe Dajci.

Në këtë kuadër përcaktohet nevoja që Plani Strategjik i Zhvillimit të adresojë këtë çështje duke propozuar një skemë të mirefillte menaxhimi të grumbullimit, transportit dhe venddepozitimit



të mbeturinave urbane, duke u bazuar në maksimalizimin e burimeve dhe bashkëpunimit por edhe në reduktimin e kostove për realizimin e tij.

2.4.11 Varrezat Publike

Varrezat publike në territorin e Bashkisë Vau i Dejës ndodhen në kodrën përballë qytetit, pranë rrugës kryesore Shkodër Pukë. Praktikisht ky shërbim nuk paraqet problem për zonën; territori është i lirë, kështu që është e mundur zgjerimi i mëvonshëm i

varrezës publike. Varrezat mirëmbahen nga Bashkia, e cila është përgjegjëse për funksionimin e saj, pastrimin e zonës si dhe gjelberimin. Varreza të tjera ndodhen edhe në malin e Shën Markut.

2.4.12 Zhvillimi social

Në termat e objektivave të mijëvjeçarit të zhvillimit në tërësi, Rajoni i Shkodrës ka një Indeks të Zhvillimit Njerëzor më të ulët se rajonet e tjera të Shqipërisë. Kjo gjendje karakterizohet nga një varfëri më e thellë, mundësi të kufizuara për shërbime, kryesisht të lidhura me aksesin për arsim dhe shëndetësi, shanse të uleta në raport me përfshirjen në jetën sociale dhe kulturore dhe standart të ulët në lidhje me cilësinë e jetesës.

Në të njëjtën kohë ndryshimet demografike, tranzicioni i gjatë dhe lëvizjet e parametrave social-

ekonomik kanë sjellë nevojën për përmirësime rrënjësore të shërbimeve dhe infrastrukturave në funksion jo vetëm të adresimit të nevojave të komunitetit dhe realizimit të funksioneve administrative të pushtetit vendor, por mbi të gjitha me synimin për rritjen e cilësisë së jetesës së banorëve në kuptimin e mirëqënies shpirtërore, kulturore dhe sociale.

Aktualisht aktiviteti shoqëror dhe kulturor në Bashkinë Vau i Dejës është padyshim në nivele të

ulëta të cilat nuk adresojnë dhe kënaqin nevojat e njerëzve për përfshirje në jetën sociale apo kulturore.

Në territorin e Bashkisë përveç objekteve të kultit, përkatësisht 7 kisha dhe 1 xhami, me ndihmën e një financimi gjerman (KFV) është ngritur kinemaja e qytetit me një kapacitet prej 150 vendesh, e cila shërben gjithashtu edhe për aktivitete komunitare apo festive të ndryshme. Pasqyra e përgjithshme e jetës shoqërore reflekton megjithatë një apati të theksuar në lidhje me jetën publike dhe kryerja e aktiviteteve nuk ka një axhendë të udhëhequr apo të organizuar për komunitetin. Në këtë kuadër nismat e Bashkisë Vau i Dejës do të realizojnë jo vetëm rritjen e cilësisë së shërbimeve por të lehtësojnë proceset që lidhen me jetën më të gjerë sociale dhe kulturore

të këtij komuniteti. Të gjitha këto nisma shërbejnë jo vetëm për të adresuar nevojat emergjente për plotësimin dhe përmirësimin e shërbimeve, por mbi të gjitha për synuar një objektiv me afatgjatë dhe vizionar, rritjen e cilësisë së jetesës dhe mirëqënies së përgjithshme së komunitetit vendas.

Në Bashkinë Vau i Dejës funksionon një skuadër e sportit luftarak Judo, me afërsisht 25 pjesëmarrës. Në Bashki ka edhe një skuadër futbollit të femrave ndërkohë që ngritja e një skuadre të konsoliduar është një nga objektivat kryesore të administratës në të ardhmen. Edhe Kisha Katolike ka organizuar një sërë aktiviteteve të ndryshme sportive me të rinjtë.

2.4.13 Popullsia

Situata pas viteve 90' për Bashkinë e Vaut të Dejës solli ndryshime ashtu si edhe për shumë njësi të tjera vendore jo vetëm në rajonin e veriut, por në mbarë vendin. Popullsia në këtë zonë ka ardhur duke u rritur për shkak të rritjes natyrore të popullsisë si dhe të zhvendosjes së shumë familjeve të zonave të thella lindore në terrenet fushore të Vaut të Dejës. Sipas të dhënave të Bashkisë Vau i Dejës, në këtë Bashki numerohen rreth 78 familje të reja që janë vendosur në këtë zonë pas viteve 90.

Popullsia e Bashkisë Vau i Dejës numëron rreth 12,330 banorë në total, nga të cilët 6,087 banojnë në qytetin e Vaut të Dejës ndërsa 6,245 banojnë në fshatrat e administruara nga kjo Bashki.

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, vihet re se gati 35% e popullsisë, apo një numër prej 4,145 banorësh janë në moshë të re, nën 18 vjeç. Ndërkohë që popullsia e aftë për punë përbën rreth 50% të totalit. Nga keto të dhëna evidentohet

| Nr | Emërtimi | 0-6 vjeç | 7-18 vjeç | 19-64 vjeç | mbi 65 vjeç | Total |
|----|-----------------------------|----------|-----------|------------|-------------|--------------|
| 1 | Qyteti Vau-Dejës | 731 | 1216 | 2631 | 902 | 5480 |
| 2 | Lagjia Dejë | 81 | 141 | 213 | 46 | 481 |
| | Shuma (për qytetin) | 812 | 1357 | 2844 | 948 | 5961 |
| 3 | Fshati Mjedë | 94 | 491 | 1223 | 247 | 2055 |
| 4 | Fshati Spathar | 65 | 125 | 197 | 30 | 417 |
| 5 | Fshati Shelqet | 51 | 281 | 702 | 100 | 1134 |
| 6 | Fshati Kaç | 44 | 266 | 635 | 60 | 1005 |
| 7 | Fshati Naraç | 63 | 238 | 513 | 50 | 864 |
| 8 | Fshati Dush | 18 | 47 | 84 | 25 | 174 |
| 9 | Fshati Gomsiqe | 20 | 60 | 100 | 24 | 204 |
| 10 | Fshati Karmë | 35 | 78 | 170 | 42 | 325 |
| | Shuma (për fshatrat) | 390 | 1586 | 3624 | 578 | 6178 |
| | Totali si Bashki | | | | | 12139 |

Tabelë e të dhënave për popullsinë në Bashkinë Vau i Dejës (Tetor 2005)

potenciali i madh nga pikëpamja e krahut të punës në këtë Bashki.

Gjithashtu vihet re numri i ulët i popullsisë në fshatrat e thella të zonës si Dush, Gomsiqe dhe Karme. Duke marrë në konsideratë gjithashtu edhe distancën e largët të këtyre fshatrave nga qendra e Bashkisë, gjë që ndikon në rënien e efikasitetit dhe pamundësinë e ofrimit të shërbimeve të përshtatshme për këto zona, është e nevojshme që autoritetet lokale të ndër marrin politika afatgjata në mënyrë që të stimulojnë dhe të orientojnë zhvendosjen e banorëve të këtyre zonave drejt territoreve perëndimore të Bashkisë. Në Planin e Përgjithshëm Rregullues të Bashkisë evidentohet mundësia reale që ka qyteti i Vaut të Dejës, nga pikëpamja e hapësirës urbane dhe dendësive, për të akomoduar rritjen e popullsisë nga zhvendosjet e reja.

Është interesante të vihet re një luhatje e popullsisë së qytetit të Vaut të Dejës, e cila ka arritur vlerën e saj më të madhe në vitin 2000 duke kaluar gradualisht drejt rënies me vlera të ulëta. Ndërkohë që fshatrat përgjatë rrugës kryesore nacionale si Mjeda dhe Shelqeti po përballen me rritje të popullsisë. Pa u futur në mënyrë të detajuar në analizën dhe vërtetësinë e të dhënave, ky fakt imponon marrjen e masave të nevojshme nga ana e autoriteteve vendore të Bashkisë Vau i Dejës, të cilat duhet të ndikojnë në mënyrë të kujdesshme në balancimin e zhvillimeve në këto fshatra përgjatë rrugës kryesore me zhvillimin në qytetin e Vaut të Dejës. Është tepër e domosdoshme që të ndërmerren masa dhe investime të nevojshme në qytetin e Vaut të Dejës, sipas përcaktimeve të Planit të ri të Përgjithshëm Rregullues të qytetit, në mënyrë që qyteti të rimarrë pozicionin e vet dominues në organizimin dhe funksionet e njësive të ndryshme urbane brenda territoreve të Bashkisë Vau i Dejës.

| Emërtimi | Vitet | | | | | | | | | | | | |
|---------------------|-------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|------|
| | 1994 | 1995 | 1996 | 1997 | 1998 | 1999 | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 |
| Vau-Dejës | | | | | | | 5836 | 5631 | 5647 | 5627 | 5659 | 5458 | 5503 |
| Dejë | | | | | | | 479 | 542 | 495 | 494 | 508 | 486 | 492 |
| Shuma (për qytetin) | 3898 | 4430 | 5328 | 5557 | 5704 | 5780 | 6315 | 6173 | 6142 | 6121 | 6167 | 5944 | 5995 |
| Mjedë | 1746 | 1737 | 1748 | 1753 | 1785 | 1801 | 1811 | 1912 | 1944 | 1970 | 1933 | 2062 | 2085 |
| Spathar | 410 | 365 | 369 | 369 | 382 | 381 | 381 | 379 | 388 | 422 | 387 | 415 | 425 |
| Shelqet | 1049 | 1029 | 1003 | 1002 | 1010 | 1008 | 1009 | 1049 | 1049 | 1094 | 1048 | 1135 | 1142 |
| Kaçe | 878 | 897 | 905 | 898 | 904 | 913 | 909 | 936 | 949 | 970 | 941 | 1012 | 1019 |
| Naraç | 1072 | 1024 | 887 | 895 | 879 | 868 | 867 | 882 | 885 | 840 | 881 | 869 | 957 |
| Dush | 905 | 609 | 341 | 328 | 307 | 319 | 322 | 311 | 313 | 295 | 312 | 175 | 175 |
| Gomsiqe | | | 222 | 225 | 221 | 237 | 244 | 238 | 232 | 221 | 237 | 204 | 194 |
| Karme | 610 | 526 | 403 | 399 | 402 | 388 | 392 | 385 | 394 | 345 | 387 | 327 | 322 |

2.4.14 Arsimi

Sistemi arsimor në Shqipëri është i organizuar në mënyrë të tillë, ku sipas ligjit në fuqi, pushteti vendor është pjesërisht përgjegjës për ofrimin e këtij shërbimi, por varësia e këtij të fundit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Drejtoria Arsimore Shkodër ndikon në cilesinë e tij. Arsyeja e kësaj situatë të

krijuar lidhet me ushtrimin e kompetencave të kufizuara vetëm në lidhje me shërbimet që duhet të ofrojë institucioni i Bashkisë të lidhura me infrastrukturën fizike të institucioneve arsimore, ndërkohe që perzgjedhja e mësuesve, vendosja e kriterëve për kualifikim, metodologjia e procesit të



Pamje nga shkolla e mesme ne fshatin Mjedë

mësimdhënies dhe jo vetëm por edukimit në tërësi, e mbi të gjitha zbatimi e monitorimi i të gjithave sa më sipër varen nga Qarku si njësi. Kjo kushtëzon në masë shumë të madhe koordinimin me këtë njësi për sigurimin e një shërbimi më eficient dhe më të përgjegjshëm ndaj nevojave dhe detyrimeve ndaj edukimit të gjenerates së re.

Nga të dhënat e Bashkisë, numri i fëmijëve që frekuentojnë 8 shkollat në të gjithë zonën është

rreth 1150 fëmijë ndërsa numri total i fëmijëve që janë në moshë shkolle (9 vjeçare) është 2943. Kjo statistikë eidenton nevojën për ndërhyrje që stimulojnë rritjen e frekuentimit të shkollave të të dy cikleve, si në qytet por sidomos në fshatrat e Bashkisë.

Bashkia e Vaut të Dejës numëron aktualisht 5 kopshte ku edukohen 250 fëmijë, 9 shkolla fillore dhe 2 shkolla nëntë-vjeçare, përkatësisht të frekuentuara nga 1700 dhe 416 nxënës. Mundësite për shkollim nuk janë në standartin e kërkuar, pasi nxënësit mësojnë me klasa te kombinuara dhe kushtet fizike të ndërtesave nuk janë në gjendjen e dëshiruar për të zhvilluar një proces normal dhe cilësor mësimdhënie. Mungon baza e materialeve didaktike dhe sidomos laboratoreve (kjo situatë megjithatë është e vlefshme njësoj edhe për rajonin dhe vendin në përgjithësi) dhe shpeshherë karakterizohen nga një numër nxënësish për klasë që e tejkalon standartin e vendosur. Keshtu nga standarti 20-30 nxënës për klase, në kushte të caktuara numri mund të arrijë dhe 45-50 nxënës për klasë.

2.4.15 Aktivitetet sportive

Institucionet sportive të bashkisë aktualisht mungojnë në bashkinë e Vaut të Dejës. Egzistojnë vetëm pak fusha private minifutbolli në qytetin e Vaut të Dejës si dhe në fshatrat përgjatë rrugës kryesore. Sigurimi dhe mirëmbajtja e mjediseve sportive në qendrat arsimore është përgjegjësi e bashkisë. Megjithatë, është e rëndësishme që ne politikat për rregullimin dhe administrimin e territorit, siç është përgatitja e Planeve Rregulluese për qytetin e Vaut të Dejës si dhe të fshatrave

te tjere, të merren parasysh krijimi i hapësirave sportive brenda zonave të banimit në mënyrë që të stimulohen këto aktivitete të nevojshme për shëndetin e banoreve dhe popullatës.

Siç është përmendur edhe më lart, në Bashkinë Vau i Dejës funksionon vetëm një ekip për të rinj i sportit JUDO, si dhe ekipi i futbollit të femrave, ndërkohe që nuk ka asnjë aktivitet sportiv formal të regjistruar. Një nga objektivat afatshkurtër të Bashkisë është edhe ngritja e ekipit lokal të futbollit.

2.4.16 Zhvillimi dhe Integrimi Gjinor

Sipas të dhënave të Bashkisë, çështjet gjinore në këtë zonë i referohen mundësisë së femrave për punësim si dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje. Aktualisht, femrat në Bashkinë Vau i Dejës përbëjnë rreth 49% të popullsisë aktive ndërkohe që nga të dhënat e përmendura më lart, në pjesën e punësimit

në Bashkinë Vau i Dejës, vihet re që edhe në qytet por edhe në fshat femrat kishin përqindjen më të lartë të papunësisë.

Pjesëmarrja në vendimarrje eidentohet në numrin e femrave të angazhuara në qeverisjen vendore.

Nga 32 anëtarë të administratës, vetëm 10 janë femra ndërkohe që numri i femrave në keshillin vendor të Bashkisë është 0 nga 17 që është numri i këshilltarëve.

Nga të dhënat e Bashkisë në vite është e vështirë që të identifkohet numri i saktë i rasteve të dhunes

mbi gratë. Akoma më e vështirë është situata për sa i përket rasteve të tilla në zonat rurale.

Në periudhën Shtator 2006 dhe Mars 2008, në territorin e Bashkisë Vau i Dejës ka funksionuar në shoqatë e misionareve të të drejtave të njeriut, e cila është angazhuar me gratë, fëmijët si dhe me grupe të tjera me probleme sociale.

2.4.17 Shëndeti publik

Praktikisht, në territorin e Bashkisë Vau i Dejës funksionojnë 6 qendra shëndetësore, të shpërndara në Qytetin e Vaut të Dejës, Mjedë, Shelqet. Këto qendra shëndetësore parësore ofrojnë shërbime e ndërhyrjes së shpejtë, mjekime të lehta si dhe vizita të përgjithshme. Ndërkohë që qendra shëndetësore e qytetit të Vaut të Dejës siguron edhe shërbime gjinekologjike, si dhe maternitetet.

Duke parë shtrirjen e madhe territoriale të kësaj Bashkie, tendencën për rritje urbane si dhe largësinë nga qendra spitalore e specializuar, Spitali i Shkodrës, që ndodhet 19 km larg, është evidentuar nevoja për ngritjen e një spitali të vogël në funksion të nevojave emergjente të për popullsinë e kësaj Bashkie. Aktualisht Bashkia Vau i Dejës ka përgatitur një projekt për ngritjen e këtij spitali, i cili do të ofrojë shërbime të ndryshme klinike. Gjithsesi, problem mbetet identifikimi i vendit dhe sigurimi i parcelës për ngritjen e tij pasi Bashkia nuk ka mundësi financiare për blerjen e kësaj parcele.

Për shkak të shtrirjes sipërfaqësore të vogël të qendrave urbane, në të gjithë territorin e Bashkisë Vau i Dejës, nuk evidentohen probleme serioze që kanë të bëjnë me ndotjen. Ashtu siç është përmendur edhe më lart, problematikë mbetet mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza në pjesën më të madhe të fshatrave si dhe të qytetit të Vaut të Dejës. Rreziku qëndron tek ndotja e ujërave nëntokësore nga filtrimi i ujërave të zeza nga gropat septike, të cilat shërbejnë edhe si burimi kryesor i ujit të pijshëm për pjesën më të madhe të banorëve të zonës. Një problem i madh i zonës është mungesa e një pike të përshtatshme për depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave urbane. Shumica e mbeturinave tashmë depozitohen përgjatë rrugës kryesore, në të hyrë të qytetit Vau i

Dejës, si dhe përgjatë kanaleve të ujitjes. Çështje të tjera që kanë të bëjnë shëndetin publik në këto zona si psh, mbrojtja nga sëmundjet epidemike, vaksinimet etj janë subjekt i punës së Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë.



Foto e qendrës shëndetësore në qytetin Vau i Dejës

Veprime duhet të merren për shkatërrimin dhe pastrimin e ndërtesave të kabanoneve të vjetra të Hidrocentralit, në të cilat aktualisht banojnë familje të shpërngulura nga krijimi i liqenit artificial. Ekzistenca e azbestit në mbulesën prej eterniti të këtyre strukturave ka krijuar nevojën urgjente për shkatërrimin dhe pastrimin e zonës nga ky material si dhe strehimin e banorëve ekzistues në banesa të përshtatshme.


2.4.18 Struktura Hapësinore Urbano Rurale

Territori i Bashkisë shtrihet pjesërisht në zonë kodrinore malore në Lindje dhe pjesërisht në zonën perëndimore fushore. Një pjesë e territorit të Bashkisë përbëhet edhe nga liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës. Pjesa më e zhvilluar urbane, në mënyrë të natyrshme, është e pozicionuar përgjatë zonës fushore në perëndim.

Për shkak të pozicionit gjeografik specifik të Bashkisë si dhe kalimi i rrugës kombëtar Shkodër Pukë mospërmes territorit të saj ka ndikuar në një konfiguracion urban të veçantë. Ajo që të bie menjeherë në sy është pozicionimi jo i favorshëm i qendrës më të madhe, pra i qytetit të Vaut të Dejës,

në një largësi më të madhe me Shkodrën se fshatrat e tjerë të saj si Shelqet dhe Mjeda. Pjesa më e madhe e zonave urbane shtrihen në zonat fushore dhe aksi rrugor kryesor kombëtar përshkon pikërisht zonat më të dendura urbane të Bashkisë. Nga pikëpamja e aksesit fshatrat në zonën fushore janë më të privilegjuara se sa qyteti i Vaut të Dejës, duke bërë që të ofrojnë më shumë hapësira dhe mundësi për investime.

Në të gjitha zonat urbane të marra në konsideratë dendësia e banimit është relativisht e ulët, sidomos në fshatrat Shelqet, Kaç dhe Naraç, si dhe në lagjen periferike Kapedani të qytetit. Shumica e ndërtimeve



Skema e territoreve urbane dhe e rrugëve në zonën perëndimore të Bashkisë Vau i Dejës

të reja në këto zona janë informale, pra banesa të ndërtuara nga pronarët e tokës por me mangësi në procedurat ligjore të ndërtimit.

Në përgjithësi, në këtë zonë vihet re një tendence e përgjithshme për të ndërtuar në tokat bujqësore, gjë që përbën një problem të madh për Bashkinë si dhe për potencialet e saj natyrore. Në këtë kontekst është e rëndësishme që të ndërhyet në mënyrë të menjëhershme duke identifikuar kufijtë e propozuar urbane si dhe kriteret bazë për ndërtimin në të ardhmen. Gjithashtu Bashkia Vau i Dejës duhet të

rrisë kapacitetin e saj për kontrollin e territoreve urbane dhe rurale me qëllim për të ruajtur dhe balancuar zhvillimin urban të saj me potencialet ekonomike të zonave rurale.

Së fundmi, Bashkia Vau i Dejës, ka përfunduar Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit. Ky Plan i ri synon në konsolidimin e strukturës ekzistuese urbane, përmirësimin e komunikimit dhe aksesit midis zonave të ndryshme të qytetit si dhe vijen e verdhë të re, e cila përcakton qartë kufijtë e rinj të propozuar të zonës së ndërtimit nga territoret rurale apo mjedisi natyror rrethues.

2.4.19 Strehimi

Zyrtarisht, në Bashkinë Vau i Dejës nuk janë të rregjistruara familje të pastreha. Megjithatë, një problem të madh për Bashkinë Vau i Dejës përbën egzistenca e banesave “kapanone” në pjesën veriore të qytetit, të cilat para 90 përdorshin nga punëtorët e Hidrocentralit. Tashmë në këto ndërtime janë instaluar shumë familje të cilat janë zhvendosur nga zonat që u përmblyten nga liqeni i hidrocentralit. Kushtet e banimit në këto ndërtesa janë të vështira, me hapësira të ngushta si dhe të

patrajuara nga pikëpamja e izolimit termik. Për më tepër mbulesa e këtyre ndërtesave përbëhet nga material eterniti, me përqindje amianti, një material ky tepër i dëmshëm për shëndetin përdorimi i të cilit në Europë është ndaluar që në Janar të 2005.

Lidhur me këtë problem Bashkia Vau i Dejës është shprehur gjithnjë e interesuar për prishjen e banesave “kapanone” dhe ndërtimin në vend të tyre të banesave sociale me të përshtatshme.

Në Planin e ri Rregullues të Qytetit identifikohet pikërisht transformimi i kësaj zone me probleme në një zonë të re banimi me kriteret e posaçme sipas rregullores bazë të urbanistikës. Problem themelor mbetet përsëri mungesa e financimeve për këtë proces.

Ndërkohë, si në qytet ashtu edhe në fshatrat e Bashkisë, egzistenca e hapësirave të lira si dhe mungesa e kontrollit nga ana e autoriteteve ka çuar në ndërtimin e shumë banesave të reja pas viteve 90, duke i dhënë në këtë mënyrë zgjidhje nevojave të strehimit të popullsisë.



Foto e zonës së “kapanoneve” të vjetra të ndërmarrjes së Hidrocentralit

2.4.20 Mjedisi i shëndetshëm


Kjo çështje prek elementë si mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore që në territorin e Bashkisë Vau i Dejës janë të shumta. Është e rëndësishme kryerja e monitorimeve të kujdesshme të cilësisë së ujit në të gjithë zonën, për shkak të potencialit ndotës të mbetjeve urbane si dhe të ujërave të zeza që nuk trajtohen. Lidhur me këtë të fundit, Bashkia duhet të shikojë me prioritet mundësinë e ngritjes së një platforme për pastrimin e ujërave të zeza të të gjitha zonave urbane, element tepër i rëndësishëm për krijimin dhe ruajtjen e një ambienti të paster dhe të shëndetshëm. Përcaktimet teknike dhe kriteret për përgatitjen e këtyre strukturave janë objekt i punës së specialistëve të fushës si dhe të planifikuesve në nivel lokal apo rajonal.

Shtimi dhe përmirësimi i mjediseve të gjelbra sidomos pranë qendrës urbane të qytetit të Vaut të Dejës është një tjetër element i cili duhet të merret në konsideratë për krijimin e një mjedisi

të shëndetshëm dhe estetik. Kjo në rradhë të parë kërkon përcaktimin konkret në terren të zonave të gjelbra si dhe specifikimin e instrumentave për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Në Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Vaut të Dejës identifikohet krijimi i një parku të gjelbër në shpatin e kodres në lindje të qytetit. Transformimi i kësaj zone në park është menduar që të përmirësojë ndjeshëm estetikën urbane të qendrës së Vaut të Dejës, duke rritur atraksionin për këtë zonë si për banorët e zonave të tjera të Bashkisë por edhe për vizitorët e përkohshëm.


Përveç këtij parku masiv, ekzistenca e burimeve të shumta ujore duhet të shfrytëzohet nga autoritetet dhe banorët e zonës si një potencial për krijimin dhe shtimin e zonave të gjelbra. Fokus duhet të ketë korridorin polifunksional përgjatë rrugës kryesore Shkodër Puke si dhe zonat relativisht të përmytshme përgjatë lumit Drin si dhe lumit Gjadër.



Kapitulli III



Zhvillimi i Ardhshëm i Propozuar i Bashkisë



Skema e mësipërme paraqet një kuadër logjik nëpërmjet të cilit lidhet vizioni i zhvillimit, objektivat kryesore të tij si edhe veprimet konkrete të propozuara. Skema përfshin të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë e autoriteteve vendor në Bashkinë Vau i Dejës të strukturuar sipas sektoreve të ndryshëm, si edhe përcakton veprimet e duhura dhe të nevojshme për tu marrë në shqyrtim në secilin sektor përkatës.

3.1 Vizioni i Zhvillimit Të Bashkisë Vau i Dejës

Vau i Dejës si një Bashki e rëndësishme në rajonin verior të Shqipërisë, me aktivitete ekonomike të konsoliduara si dhe qendër me rëndësi për përpunimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale cilësore, si për tregun lokal ashtu edhe atë rajonal me qendër në Shkodër.

Vau i Dejës, një Bashki me një qendër urbane satelit të qytetit të Shkodrës, me hapësira dhe infrastruktura cilësore, me një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm, ku harmonizohen kulturat, fryma e bashkëpunimit dhe respektit reciprok midis banorëve.

Vau i Dejës, një Bashki me burime natyrore dhe mjedis të mirëmbajtur dhe të përmirësuar, ku ndërthuren karakteristikat e spikatura kodrinore malore në lindje të bashkisë me ato fushore në perëndim.

3.2 Drejtimet e Zhvillimit të Bashkisë sipas përcaktimeve të Grupit të Qytetarëve

Vau i Dejës si një qendër energjetike për rajonin e veriut duke sjellë burimet ekzistuese të energjisë me ato alternative në një harmoni mes njerëzve dhe mjedisit.

Gjatë angazhimit të tyre në momentet kyç të përgatitjes së dokumentit strategjik grupi i përfaqësimit qytetar përcaktoi këto prioritetet zhvillimi për Bashkinë Vau i Dejës:

- I. Orientimi i zhvillimit të ardhshëm të Bashkisë duke u fokusuar në riorganizimin dhe vënien në efikasitet të aktiviteteve të vogla të prodhimit industrial.
- II. Promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë në zonat rurale me fokus qëndrueshmëri dhe proceseve përpunuese për lokalitetin dhe rajonin.
- III. Identifikimi dhe përcaktimi i kriterëve të përdorimit të zonave ekonomike përgjatë korridorit kryesor të qarkullimit në të cilat do të stimulojnë investime të reja të mundshme në Bashkinë Vau i Dejës.
- IV. Eksplorimi i mundësive për iniciativa të turizmit me fokus turizmin kulturor / historik si dhe atë natyror liqenor, të bazuar në pasuritë e trashëguara natyrore dhe historike/kulturore.
- V. Zhvillimi i tregtisë lokale bazuar kryesisht tek prodhimet bujqësore dhe blegtorale të zonës si dhe në avantazhin që jep pozicioni gjeografik i bashkisë si pikë ndërlidhëse mes Shkodrës dhe Kosovës.

3.3 Objektivat e Përgjithshëm të Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës

1. NË FUSHËN E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Zhvillimi ekonomik i Bashkisë Vau i Dejës duke u përqëndruar në rivitalizimin e prodhimit të vogël industrial, zhvillimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale në zonat perëndimore dhe jugore të territorit të Bashkisë, promovimin e sipërmarrjes së vogël të fokusuar në sektorin e shërbimit dhe tregëtisë si krijimin e një mjedisi tërheqës për investitorët e huaj

2. NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË TERRITORIT

Përmirësimin dhe konsolidimin e strukturës hapësinore të qytetit të Vaut të Dejës si qendra kryesore urbane në këtë Bashki, si dhe të hapësirave urbane të fshatrave Mjedë, Kaç dhe Naraç në territoret fushore, duke trajtuar me kujdes transformimet polifunksionale në aksin kryesor rrugor Shkodër Pukë.

3. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË INFRASTRUKTURËS DHE SHËRBIMEVE

Rritja e kualitetit të shërbimeve publike dhe infrastrukturës fizike dhe sociale në të gjithë territorin e Bashkisë Vau i Dejës dhe kryesisht në zonën e qytetit dhe fshatrat Mjedë, Kaç dhe Naraç, duke iu përgjigjur në kohë dhe cilësi nevojave të komunitetit drejt standarteve cilësore të jetesës.

4. NË FUSHËN E PËRMIRËSIMIT TË QEVERISJES VENDORE

Rritja e kapaciteteve menaxhuese dhe administruese të pushtetit vendor në Bashkinë Vau i Dejës duke adresuar çështjet qytetare dhe reflektuar ato në politika vendore efektive.

5. NË FUSHËN E BURIMEVE FINANCIARE

Rritja e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Vau i Dejës si dhe mundësimi i financimeve për përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve në të gjithë territorin administrativ të Bashkisë.



3.4 Fushat e Ndërhyrjes

3.4.1 Objektivi A - Zhvillimi Ekonomik në Bashkinë Vau i Dejës

E parë në tërësinë e vet, zhvillimi dhe i aktiviteteve ekonomike prodhuese në Bashkinë Vau i Dejës është elementi baze i zhvillimit të përgjithshëm të kësaj Bashkie në të ardhmen. Për këtë qëllim, Plani Strategjik i Zhvillimit identifikon qartësisht si më poshtë:

A1. Zhvillimi i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale lokale, duke u fokusuar në kulturat e drithërave, perimeve dhe drurëve frutorë:

| Rezultatet e Pritshme | Veprime Konkrete |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Rritja e mbështetjes teknike dhe financiare ndaj fermerëve vendas në Bashkinë Vau i Dejës | <ol style="list-style-type: none"> Përcaktimi i një pakete ndihme financiare të përvitshme për fermerët vendas në Bashkinë Vau i Dejës me miratimin e Këshillit Vendor, si dhe vlerësimi i mundësive për financim nga ana e aktorëve të ndryshëm financiar apo bankave të nivelit të dytë. Përgatitja e projekteve të gatshme teknike për ndërhyrjet fizike në infrastrukturat bujqësore apo në parcelat e kultivuara në fshatrat e Bashkisë Vau i Dejës. Mbështetja ndaj proceseve për ngritjen e kapaciteteve për fermerët vendas në Vau i Dejës me qëllim përmirësimin e efikasitetit të tyre në punë dhe prodhimtarisë. |
| b. Përcaktimi i kapaciteteve për prodhimin e kulturave bujqësore në territorin e Bashkisë Vau i Dejës | <ol style="list-style-type: none"> Organizimi i takimeve me fermerët e Vaut të Dejës për specifikimin e qartë dhe realist të mundësive të prodhimit të kulturave bujqësore në këtë Bashki. Përgatitja e një studimi teknik ku të evidentohen kapacitetet prodhuese bujqësore në zonën e Vaut të Dejës, e fokusuar në zonën perëndimore fushore. |

| Rezultatet e Pritshme | Veprime Konkrete |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>c. Përgatitja e një studimi për vlerësimin e nevojave në lidhje me investimet që duhen për rritjen e efikasitetit të përdorimit të tokës bujqësore dhe infrastrukturave mbështetëse</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Ngritja dhe konsolidimi i një grupi pune të përbashkët (Bashkia Vau i Dejës, Drejtoria Rajonale e bujqësisë Shkodër, fermerët lokalë) që do të jetë përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e procesit të mbështetjes ndaj zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë. 2. Organizimi i debateve të hapura apo forumeve lidhur me nevojat dhe prioritetet për investime në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë 3. Hartimi i një programi / axhendë ndërhyrjesh fizike në sistemet e tokave, ujitjes dhe kullimit |

A2. Mbështetja dhe Zhvillimi i Turizmit Liqenor duke u mbështetur në potencialet që ofron Liqeni Artificial i Hidrocentralit të Vaut të Dejës

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Nxitja dhe Zhvillimi i aktiviteteve turistike në zonën e liqenit të Vaut të Dejës</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e një axhende – programi pune për organizimin e aktiviteteve turistike promovuese në bregun e Liqenit Artificial të Vaut të Dejës. 2. Konsolidimi i bashkëpunimit me Komunën Gur i Zi për institucionalizimin e ngjarjeve apo festave promovuese për liqenin e Vaut të Dejës dhe të pikës historike të Shurdhahut, me investimet e Bashkisë ku ftohen edhe operatore të ndryshëm ekonomike për bashkëpunim. |
| <i>b. Përmirësimi i gjëndjes së zonave potenciale të plazhit në Liqenin Artificial të Vaut të Dejës</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i një studimi i cili evidenton ndërhyrjet e nevojshme fizike përmirësuese në zonën e brigjeve të plazheve të liqenit artificial. 2. Ngritja e strukturave të posaçme brenda bashkisë Vau i Dejës përgjegjëse për të menaxhuar dhe kontrolluar zonën e plazheve përgjatë brigjeve të liqenit artificial. 3. Organizimi i aktiviteteve periodike të pastrimit dhe gjelbërimit të zonës së plazheve të liqenit artificial. |
| <i>c. Promovimi i zonës së plazheve të liqenit artificial të Vaut të Dejës</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e materialeve promovuese të liqenit artificial të Vaut të Dejës si psh, postera, broshura apo fletëpalosje. 2. Organizimi i takimeve me operatorë të ndryshëm ekonomike turistike ku të promovohen zonat e mundshme turistike të liqenit si dhe nevojat për bashkëpunim. 3. Ndërtimi i një plani pune të veçantë brenda bashkisë për përmirësimin periodik të faqes zyrtare në internet që ka lidhje me liqenin artificial të Vaut të Dejës. |

A3. Promovimi dhe Zhvillimi i Zonave Ekonomike përgjatë rrugës kombëtare Shkodër Pukë midis territoreve të Shelqetit, Mjedës dhe Qytetit Vau i Dejës

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Përgatitja e projekteve teknike për zhvillimin e këtij korridorit multifunksional</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e Studimeve Pjesore të Detajuara për zonën e korridorit ekonomik të përmendur përgjatë rrugës kryesore Shkodër-Pukë 2. Përgatitja e projekteve teknike të infrastrukturave (rrugë ndihmëse, ujësjellëse dhe kanalizime) |
| <i>b. Mbështetja me investime konkrete në pjesën e korridorit ekonomik të propozuar brenda territorit të Bashkisë Vau i Dejës</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e një Plani Pune lidhur me investimet dhe ndërhyrjet fizike në këtë korridor ekonomik 2. Kryerja e investimeve periodike vjetore përmirësuese duke u bazuar në Studimet Pjesore të përgatitura si dhe në Projektet teknike, të listuara në Planin e Punës së Bashkisë |

A4. Promovimi dhe ngritja e një zonë të lirë ekonomike pranë zonës së magazinave të hekurudhës, në kryqëzimin midis hekurudhës Tiranë Shkodër me rrugën nacionale Shkodër Pukë.

Gjatë vlerësimit të kryer në terren, kjo zonë është konceptuar si një zonë me mundësi për akomodimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike si prodhim, magazinim apo përpunim të produkteve. Pika ka avantazhin e të qenurit në kryqëzim të akteve të rëndësishme të aksesit, si dhe egzistencën e shumë hapësirave të lira.


| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Lobimi dhe miratimi i territorit të përmendur si zonë e lirë ekonomike për Bashkinë Vau i Dejës | <ol style="list-style-type: none"> Organizimi i takimeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave si dhe me Qarkun Shkoder lidhur me mundësinë e kthimit të zonës së propozuar në zonë të lirë ekonomike. Organizimi i takimeve periodike me zhvillues apo operatorë ekonomikë për investime të mundshme në këtë zonë të lirë ekonomike |
| b. Përmirësimi i gjendjes teknike të zonës së propozuar nga pikëpamja e infrastrukturave dhe shërbimeve | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e një vlerësimi teknik ku të identifikohen qartë nevojat për investime në infrastrukturë në këtë zonë Në bazë të vlerësimi teknik, përgatitja e projekteve konkrete të infrastrukturave dhe shërbimeve të nevojshme për zonën Kryerja e investimeve të vogla periodike për infrastrukturën fizike në zonë Përgatitja e projekt propozimeve për financim për zhvillimin e zonës ekonomike si dhe përmirësimin e infrastrukturave të nevojshme. |

3.4.2 Objektivi B. - Përmirësimi i Menaxhimit të Territorit në Bashkinë Vau i Dejës

Duke u bazuar në format dhe tendencat e zhvillimit të qytetit të Vaut të Dejës si dhe të zonave të reja urbane që po zhvillohen në përfundim të territorit administrativ, Plani Strategjik i Zhvillimit përcakton:

B1. Konsolidimin e qendrave urbane të fshatrave të zonës perëndimore të Bashkisë Vau i Dejës që korrespondon me territoret e fshatrave Mjedë, Shelqet, Kaç dhe Naraç

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Rritjen e shkallës së informimit të banorëve lidhur me përcaktimet e Planit Strategjik të Zhvillimit dhe Instrumentave të Menaxhimit të Territorit | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja dhe vendosja e tabelave të reja informuese në zonat e konsolidimit urban Përgatitja e standave të posaçme në ambientet e brendshme të Bashkisë Vau i Dejës ku të paraqiten skemat hapësinore – hartat e Planit të ri të Propozuar, si dhe kufijtë e lejuar të ndërtimeve në të ardhmen (vijat e verdhra të qytetit të Vaut të Dejës si dhe të fshatrave) |
| b. Përmirësimin e gjendjes së infrastrukturave fizike të qendrave të konsolidimit urban | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e Termave të Referencës apo Projekteve teknike konkrete të akseve të reja rrugore të propozuara apo të ndërhyrjeve në rrjetin e infrastrukturave sekondare në varësi të skemës hapësinore të propozuara |
| c. Përgatitjen e studimeve apo projekteve të rristrukurimit urban për zonat e konsolidimit urban | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e një plani pune për ndërhyrjen në zonat prioritare që do të studiohen nga drejtoria e urbanistikës së Bashkisë Vau i Dejës, objekti i të cilit është përgatitja e një pakete projektsh teknike apo Studimeve Urbanistike Pjesore. |



B2. Mbrojtjen e tokës bujqësore nga zhvillimet e pakontrolluara

Përgjatë rrugës kryesore kombëtare Shkodër Puke, që kalon përgjatë fshatrave Shelqet dhe Mjedë, por edhe në fshatrat Kaç, Naraç si dhe në zonën jugore të qytetit të Vaut të Dejës, janë ndërtuar një numër i konsiderueshem objektivash të reja me funksione kryesisht banimi por edhe me funksione shërbimesh, tregëtare dhe rekreative

Pjesa më e madhe e këtyre objekteve janë ndërtuar në tokë bujqësore, duke zënë një pjesë të konsiderueshme të saj dhe duke e dëmtuar atë në mënyrë të ndjeshme. Aktualisht nuk ka studime të plota që të identifikojnë se sa është numri i saktë i objekteve të ndërtuara në këto fshatra. Këto zhvillime argumentohen nga:

- Mungesa e kontrollit për ndërtimet e reja nga ana e autoriteteve
- Egzistenca e mentalitetit të gabuar mbi pronën, sipas të cilës, pronari mund të bëjë gjithçka mbi pronën e tij
- Mungesa e Hartave të sakta ku të identifikohet kufiri i zonës së lejuar së ndërtimeve (vija e verdhë)

Për këtë arsye, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë së Vau të Dejës propozon marrjen e masave si më poshtë:

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Rritjen e nivelit të kontrollit mbi ndërtimet e reja (Inspektoriati i Ndërtimit) në territorin e Bashkisë Vau i Dejës.</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Konsolidimin e zyrës së Inspektoriatit të Ndërtimit në Bashkinë Vau i Dejës, sipas përcaktimeve të Ligjit të ri Nr. 9780, dt. 16,7,2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit". 2. Identifikimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Inspektoriatit të Ndërtimit në Bashkinë Vau i Dejës duke qartësuar edhe kërkesat për financime të mëtejshme. |
| <i>b. Prezantimi dhe konsolidimi i masave penalizuese si dhe njohja e komunitetit vendor me këto masa.</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja dhe miratimi në Këshillin Vendor të Bashkisë Vau i Dejës të një paketë masash penalizuese për ndërtimet në tokat bujqësore nën administrimin e kësaj Bashkie. 2. Përgatitja e materialeve informuese për banorët e fshatrave të Vaut të Dejës lidhur me masat që do të merren në rastet e ndërtimeve pa leje të objekteve. |
| <i>c. Identifikimi i politikave fiskale të posaçme për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe orientimin e ndërtimeve në këto territore</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Përgatitja e një vlerësimi teknik që të përcaktojë një paketë taksash të posaçme për ndërtimet egzistuese në territoret bujqësore të Bashkisë Vau i Dejës (dhe në territoret urbane), në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore. 2. Organizimi i trainimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Vau i Dejës për të rritur nivelin e grumbullimit të taksës së pronësisë si dhe menaxhimin e tyre sidomos në lidhje me taksën mbi pronën |

B3. Rigjallërimi i zonave të dëmtuara nga aktivitetet njerëzore si dhe mbrojtja e mjedisit në Bashkinë Vau i Dejës

Praktikisht, ajo që evidentohet në lidhje me problematikat mjedisore në Bashkinë Vau i Dejës është:

- Mungesa e një sistemi eficient të grumbullimit të mbeturinave urbane në të gjithë territoret e banuara si dhe e pikave të konsoliduara të grumbullimit (kazane metalike dhe kosha të vegjël rrugore) ka bërë që në të gjithë territorin e Bashkisë dhe sidomos në kanalet ujore të evidentohen grumbuj të mëdhenj mbeturinash, sidomos shishe plastike, qeska, etj.
- Qyteti i Vaut të Dejës por edhe fshatrat e mëdhenj të kësaj Bashkie nuk kanë pika për depozitimin dhe pastrimin e ujërave të zeza. Thuajse të gjitha këto ujëra përfundojnë në sistemin hidrik ekzistues të Bashkisë duke ndikuar në ndotjen serioze të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Kjo gjë është shumë e evidente në kanalin e madh ujitës përgjatë rrugës kryesore nacionale Shkodër Pukë, pranë fshatit Mjedë.
- Bashkia Vau i Dejës nuk disponon në territorin e vet parqe të mëdhenj të gjelbër. Mungesat në këtë aspekt evidentohen më shumë në zonën e qytetit ndërsa ekzistenca e oborreve private në fshatrat ka krijuar sipërfaqe të

konsiderueshme të gjelbëruara. Plani I Përgjithshëm Rregullues i qytetit evidenton ngritjen e një parku periferik të gjelbër në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Situata e gjelbërimit në pjesën lindore kondrinore malore të bashkisë është relativisht më e mirë, ku spikat pylli me pisha përgjatë rrugës së Komanit.

Lidhur me mjedisin dhe mbrojtjen e tij, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës propozon.

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>Identifikimi i zonave që kanë nevojë për ndërhyrje përmirësuese në mjedis</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i një studimi teknik hartografik ku të specifikohen zonat e ndjeshme mjedisore në territorin e Bashkisë Vau i Dejës si dhe përcaktimi i nevojave për ndërhyrje fizike përmirësuese |
| <i>Përmirësimi i gjendjes së mjedisve të dëmtuara (ndotura) në territorin e Bashkisë</i> | <ol style="list-style-type: none"> 1. Pastrimi i zonave urbane dhe i kanaleve të ujit nga mbeturinat e pagrumbulluara si dhe depozitimi i tyre në pikën aktuale të grumbullimit 2. Gjelberimi i korridorit kryesor rrugor sidomos përgjatë fshatit Mjedë dhe rrugës hyrëse për në qytetin e Vaut të Dejës |



Instrumentat e Menaxhimit të Territorit

Në lidhje me përcaktimin dhe orientimin e shpërndarjes hapësinore të zonave të banimit, zonave me përdorim të përzier, si edhe atyre ekonomike në Bashkinë Vau i Dejës, në fund të dokumentit paraqiten hartat me shpjegimet përkatëse.

Qëllimi i materialeve hartografike është që të orientojnë ndërhyrjet hapësinore sipas objektivave kryesore të zhvillimit ekonomik, social dhe mjedisorë të Bashkisë Vau i Dejës. Gjithashtu ato janë një instrument kyç për pjesëmarrjen e publikut, duke i ofruar qoftë aktoreve private apo publikë mundësinë për të bashkëvepruar bazuar në një vision të qartë dhe të integruar. Më konkretisht këto instrumenta synojnë:

- ❖ Të drejtojnë përdorimin e përgjithshëm të tokës duke përcaktuar kornizat për zhvillimin territorial të Bashkisë Vau i Dejës.
- ❖ Të përcaktojnë korridoret kryesore të transportit
- ❖ Të përcaktojnë zonat mikse si dhe ato ekonomike
- ❖ Të merret parasysh në zhvillimin e ardhshëm të Bashkisë së Vaut të Dejës, zonat me rëndësi të veçantë dhe me funksione specifike.

A. Zonat e banimit

Zonat e banimit të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

1. Në llojin e parë janë të përfshira **Zonat e Konsolidimit Urban**, të cilat duhet të jenë subjekt për hartimin e Planeve të Përgjithshme Rregulluese, të Master Planeve tematike apo Studimeve Pjesore. Sipas këtij koncepti, këto zona duhet të plotësohen me gjithë infrastrukturën fizike dhe sociale të nevojshme si dhe shërbimet përkatëse (rrjeti rrugor, sistemi i kanalizimeve, furnizimi dhe ujë dhe energji elektrike, transporti publik, shkolla, kopshte, qendra shëndetësore e sociale etj). Dendësia e propozuar bruto në këto zona është përafërsisht 100 banore/Ha, ndërsa dendësia neto është 140 banore/Ha. Në këto zona propozohet të lejohen dhe inkurajohen (duke u bazuar në politikat vendore përkatëse) ndertime të reja me qëllim konsolidimin e zonës dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike.
2. Në llojin e dytë janë të përfshira **Zonat e Ngrirjes Urbane**, të cilat nuk paraqesin nevojë për Plane të Përgjithshme Rregulluese pasi propozimi konsiston në reduktimin dhe ndalimin e ndërtimeve të reja në të ardhmen.

B. Zonat e veçanta:

Zonat e veçanta të paraqitura në hartë ndahen në dy lloje:

- ❖ **Zonat ekonomike:** këtu do të nënkuptojmë zonat e destinuar për zhvillimin e tregtisë, industrisë së lehtë të përpunimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të zonës dhe si dhe shërbimeve përkatëse.
- ❖ **Zonat e gjelbra:** këtu përfshihen ato zona të gjelbra specifike të cilat kërkojnë një vëmendje të veçantë si psh; parku përgjatë brigjeve të lumit të Drinit dhe të Gjadrit, mbjellje e pemeve përgjatë brigjeve të lumenjve etj.

C. Zonat specifike:

Zonat specifike të paraqitura në hartë, janë ato zona të cilat janë jashtë juridiksionit të Bashkisë. Por influencojnë direkt apo indirekt në jetën e banorëve të zonës :

- ❖ **Zona e Hidrocentralit:** pavarësisht pamundësisë për të ndërhyre apo jo, zona e Hidrocentralit është pjesë e qytetit të Vaut të Dejës. Ndryshimet e relievit dhe sipërfaqeve ujore, kanë pësuar pas ndërtimit të kësaj vepre, mund të shfrytëzohen më së miri, për intersat e zonës nga pikpamja ambientale dhe turistike. Këtu mund të përmendim liqenin, si dhe pjesën e derdhjes së liqenit në pikën ku bashkohet me lumin e Gjadrit.
- ❖ **Zona Ushtarake:** nuk shihet si një pozicion i favorshëm pozicioni i repartit ushtarak në lidhje me zonën e banuar në qytetin e Vaut të Dejës. Rritja e vazhdueshme dhe dendësimi i “njollës” urbane, thuajse e kanë përfshirë repartin ushtarak në brendësi të zonës së banuar. Është e rëndësishme që të merret parasysh llojet e funksioneve të ndryshme që mund të kryhen brenda zonës ushtarake, për tu paraprirë problemeve të ndryshme dhe për të plotësuar kushtet e sigurisë për banorët e zonës.


Objektivat që kanë orientuar propozimet e mësipërme janë:


- *Të ndihmojnë në konsolidimin e zonave urbane.*
- *Të ndihmojnë në dendësimin dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve në zonat urbane.*
- *Të ndihmojnë në uljen e kostove të investimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturave në zonat urbane e më tej.*

Këto instrumenta të paraqitura në mënyrë skematike orientojnë studimet e sipërpërmendura në baze të prioriteteve dhe të planeve të veprimit siç përcaktohen në këtë Plan Strategjik Zhvillimi.

Bashkia e Vaut të Dejës, nëpërmjet instrumentave të menaxhimit të territorit ka evidentuar hapin e parë drejt studimeve të detajuara, që do t'i nevojiten në të ardhmen për të organizuar territorin e saj si njësi vendore, bazuar në maksimalizimin e burimeve dhe minimizimin e kostove.

**PLANI STRATEGJIK
BASHKIA VAU I DEJES
PERDORIMI I TOKES**





LEGJENDA

PLAN RREGULLUES NE PROCES NE ZONE URBANE TE QYETT



ZONAT QE DO TE PLOTESOHEN ME STUDIME URBANE & PROJEKTET E INFRASTRUKTURAVE (STUDIME URBANE, PLANE RREGULLUESE, STUDIME PËSONE, DIZAIN URBAN ETJ.)



ZONA NE NGRIRJE



ZONA NE TE CILAT JAME TE NEVOJSHME STUDIME MJEDISORE



BY-PASS-I AKS I RI I PROPOZUAR



RRUGE NACIONALE




RRUGE RURALE



HEKURUDHE



SUPERFAQE UJORE



HIDROCENTRAL



ZONE USHTARAKE



VAU I DEJËS MUNICIPALITY
 Bashkia e Vauit të Dejës
 Komuna e Vauit të Dejës

Co-PLAN
 CONSULTING & PLANNING
 CONSULTANTS

inter-cooperation
 CONSULTING & PLANNING
 CONSULTANTS

3.4.3 Objektivi C. -Infrastruktura dhe Shërbimet Publike

Bashkia Vau i Dejës ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë sipas funksioneve të përshkuara në ligj për sigurimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturave sociale dhe fizike si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

Duke u bazuar në gjendjen egzistuese të evidentuar në profilin e Bashkisë në Kapitullin II si dhe në drejtimet e propozuara të zhvillimit të kësaj Bashkie, Plani Strategjik i Zhvillimit propozon:

C1. Përmirësimin e gjendjes së rrjetit rrugor në Bashkinë Vau i Dejës duke u bazuar në skemën e propozuar në Planin e Përgjithshëm Rregullues si dhe në përmirësimin e komunikimit të fshatrave të ndryshëm në të gjithë territorin e kësaj Bashkie.

| <i>Rezultatet e Pritshme</i> | <i>Veprimet Konkrete të Propozuara</i> |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Zbatimi i planit të rrjetit rrugor të propozuar në Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit si dhe në materialit e tjerë hartografike</i> | 1. Pikëtimi në terren i akseve dhe profileve rrugore të propozuara në Planin Rregullues të Përgjithshëm të qytetit dhe në hartat e Planit Strategjik të Zhvillimit duke identifikuar vijën e ndërtimit, si dhe aksin e rrugës së propozuar |
| <i>b. Hartimi i projekteve të ndërhyrjes në rrjetin rrugor duke u bazuar në skemën e Planit Rregullues të propozuar</i> | 1. Përgatitja e projekt propozimeve të posaçme duke ia adresuar donatorëve potenciale, për financimin e procesit të hartimit të Projekteve Teknike në lidhje me ristrukturimin dhe përmirësimet fizike të rrugëve të reja të propozuara 2. Përgatitja e Detyrave të Projektimit nga ana e Bashkisë Vau i Dejës për ti paraprirë përgatitjes së Projekteve Teknike për akset rrugore. |
| <i>c. Kryerjen e investimeve përmirësuese për rrjetin rrugor të propozuar</i> | 1. Përgatitja dhe miratimi i një plani ndërhyrjesh përmirësuese në rrjetin rrugor të qytetit si dhe të gjithë fshatrave të zonës perëndimore të Bashkisë Vau i Dejës. 2. Fillimi i punës për rehabilitimin bulevardit kryesor të qytetit të Vaut të Dejës si dhe të rrugëve të tjera kryesore sipas skemës së propozuar në Planin e Përgjithshëm Rregullues |

C2. Përmirësimi i gjendjes së ujësjellës kanalizimeve në territorin e Bashkisë Vau i Dejës

Shumë shpejt, përgjegjësia për menaxhimin e ndërmarrjes së ujësjellës kanalizimeve do të transferohet tërësisht Bashkisë Vau i Dejës. Për këtë arsye është e nevojshme që të ndërmerren këto masa të menjëhershme:

| <i>Rezultatet e Pritshme</i> | <i>Veprimet Konkrete të Propozuara</i> |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Përmirësimi i kushteve teknike dhe menaxhuese të drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë Vau i Dejës</i> | 1. Kryerja e një inventari të plote ku të identifikohen të gjitha asetet fizike dhe kapitalet që disponon Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë Vau i Dejës 2. Përgatitja e një skeme përmirësimi dhe investimi për logjistikën dhe zyrat e Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë Vau i Dejës. 3. Alokimi dhe miratimi në Këshillin Vendor të Bashkisë të financimit për përmirësimin e gjendjes teknike të zyrës së Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve |
| <i>b. Përmirësimi i gjendjes fizike të rrjetit të ujësjellës kanalizimeve në territorin e Bashkisë</i> | 1. Përgatitja e projekteve teknike për përmirësimin e rrjeteve të shpërndarjes së ujit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në përputhje me propozimet për organizimin dhe konsolidimin e zonave urbane të qytetit dhe të fshatrave të Bashkisë Vau i Dejës 2. Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e projekteve për përmirësimin e ujësjellës kanalizimeve për qytetin dhe fshatrat e Bashkisë Vau i Dejës |
| <i>c. Rritja e kapaciteteve të stafit të ndërmarrjes për menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjes</i> | 1. Financimi dhe organizimi i trainimeve të nevojshme për stafin e ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve për përmirësimin e efijencës dhe shërbimit |

C3. Përmirësimi i gjendjes së grumbullimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane në të gjithë territorin e Bashkisë

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Përgatitja e një Plani grumbullimi dhe menaxhimi të mbeturinave urbane në territorin e Bashkisë. | <ol style="list-style-type: none"> Vlerësimi i gjendjes egzistuese të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane në Bashkinë Vau i Dejës, duke specifikuar sasi të ditore të mbetjeve të prodhuara, llojet e këtyre mbetjeve, format e grumbullimit, kostot përkatëse si dhe tarifën e shërbimit. Përgatitja e një Plani Menaxhimi të Mbeturinave duke u fokusuar në uljen e kostove të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, rritjen e të ardhurave nga tarifën e pastrimit si dhe rritjen e performancës së shërbimit. |
| b. Identifikimi i një pike për depozitimin e mbeturinave. | <ol style="list-style-type: none"> Hartimi i një studimi teknik për përcaktimin dhe vlerësimin e vendit për ngritjen e një landfilli inxhinierik për depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave urbane në territorin e Bashkisë. |

C4. Përmirësimi i gjendjes së shkollave dhe kopshteve në territorin e Bashkisë Vau i Dejës

Bazuar në përcaktimet ligjore lidhur me këto funksione, ku Bashkia Vau i Dejës është përgjegjëse për mirëmbajtjen fizike të shkollave të mesme dhe nëntëvjeçare, ndërkohe që sistemi i mësimdhënies është nën administrimin e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Plani Strategjik i Zhvillimit të kësaj Bashkie propozon:

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Evidentimi i nevojave për përmirësime fizike në shkollat e Bashkisë Vau i Dejës | <ol style="list-style-type: none"> Hartimi i një vlerësimi teknik ku të evidentohet gjendja egzistuese e shkollave në territorin e Bashkisë, nevojat për riparime dhe përmirësime fizike të tyre. |
| b. Përgatitja e projekteve teknike për financime të mundshme nga sektori shtetëror apo donatorë të ndryshëm | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e projekteve teknike nga ana e zyrës së projektimit në Bashki për formën dhe mënyrat e ndërhyrjeve fizike në kopshte dhe shkolla. |
| c. Nxitja e forumeve lokale lidhur me mundësinë e rritjes së cilësisë së mësimdhënies në shkollat e Bashkisë | <ol style="list-style-type: none"> Ngritja dhe konsolidimi i këshillave prindërore në të gjitha shkollat e Bashkisë Vau i Dejës Promovimi dhe organizimi i mbledhjeve periodike me grupet mësimore dhe me prindërit për të diskutuar përmirësimin e faciliteteve shkollore në shkollat e Bashkisë Vau i Dejës |

C5. Gjelbërimi i mjediseve në Bashkinë Vau i Dejës

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet konkrete të propozuara |
|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Përmirësimi i kushteve fizike të mjediseve të gjelbra në territorin e Bashkisë | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e projekteve teknike për rehabilitimin e gjelbërimit të rrugëve egzistuese në Bashkinë Vau i Dejës në përputhje me propozimet e Planit të Përgjithshëm Rregullues dhe skemës rrugore të paraqitur në hartat e Planit Strategjik i Zhvillimit. Përgatitja e projektit teknik për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Parkut Periferik të qytetit të Vaut të Dejës. Organizimi dhe financimi periodik i proceseve të mbjelljes së drurëve përgjatë rrugëve dhe zonave përgjate brigjeve të lumenjve Drin dhe Gjadër si dhe në Parkun Periferik të qytetit |

C6. Përmirësimi i Sistemit të Ndrëçimit Rrugor

Ky shërbim evidentohet vetëm përgjatë rrugëve të qytetit të Vaut të Dejës si dhe në disa segmente të rrugës nacionale Shkodër Pukë. Problematik mbetet ndrëçimi në pjesë të veçanta të qytetit si dhe në territoret e brendshme të fshatrave të Bashkisë.

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet konkrete të propozuara |
|---------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Përmirësimi i gjendjes së ndrëçimit rrugor në qytetin e Vaut të Dejës</i> | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e projekteve teknike për rehabilitimin dhe përmirësimin e ndrëçimit rrugor përgjatë rrugëve kryesore të qytetit të Vaut të Dejës bazuar në specifikimet teknike të dhëna në Planin e Përgjithshëm Rregullues Përmirësimi i ndrëçimit rrugor në rrugët kryesore të qytetit Vau i Dejës |
| <i>b. Përmirësimi i ndrëçimit rrugor në fshatrat e Bashkisë.</i> | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e projekteve teknike për ndrëçimin e rrugëve të brendshme të fshatrave të zonës perëndimore të Bashkisë Vau i Dejës Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e ndrëçimit rrugor në fshatrat e Bashkisë. |

C7. Menaxhimi i Varrezave Publike

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet konkrete të propozuara |
|---------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Përmirësimi i kushteve aktuale të varrezave publike në Bashkinë Vau i Dejës</i> | <ol style="list-style-type: none"> Sistemimi i hapësirave të brendshme të varrezave publike Kryerja e gjelbërimit periodik të varrezave publike Asfaltimi i rrugës së varrezave publike |

C8. Menaxhimi i Shërbimit të Dekorimit

Me përjashtim të disa ndërhyrjeve të vogla në qytetin e Vaut të Dejës, në fshatra mungon thuajse tërësisht shërbimi i dekorit. Në këtë aspekt Plani Strategjik i Zhvillimit propozon:

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet konkrete të propozuara |
|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <i>a. Përmirësimi i imazhit të zonave urbane dhe dekorimi i tyre</i> | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e planit vjetor të investimeve lidhur me zbulimin dhe përmirësimin estetik të zonave urbane të qytetit si dhe zonat e konsolidimit urban në fshatrat e Bashkisë Organizimi dhe financimi i ndërhyrjeve përmirësuese përgjatë rrugëve kryesore të qytetit dhe të fshatrave |

C9. Rritja e Nivelit të Punësimit – Mundësitë për Grupet në Nevojë

Punësimi është një komponent i lidhur direkt me aktivitetet stimuluese të rritjes ekonomike dhe zhvillimin, që janë përmendur në pjesën e mësipërme të dokumentit. Në vazhdim të saj, Bashkia duhet të promovojë veprime specifike për të rritur mundësitë e punësimit për grupet e ndryshme në nevojë në territorin e vet.

Në këtë kuadër, Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës propozon:

| Rezultate të Pritshme | Veprime Konkrete të Propozuara |
|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Rritja e kapaciteteve profesionale të banoreve vendas në Bashkinë Vau i Dejës | <ol style="list-style-type: none"> Organizimi i kurseve të ndryshme periodike të trainimeve profesionale për grupet në nevojë në Bashkinë Vau i Dejës Përgatitja e projekt propozimeve të ndryshme për donatorët, për financimin e projekteve të ndryshme të punësimit social për grupet në nevojë në Bashkinë Vau i Dejës |
| b. Organizimi i aktiviteteve për punësimin periodik të grupet në nevojë | <ol style="list-style-type: none"> Financimi i projekteve të infrastrukturës në territorin e Bashkisë Vau i Dejës ku të punësohen përfaqësues të grupeve në nevojë |

3.4.4 Objektivi D. - Qeverisja e Mirë Vendore

Për sa i përket këtij komponenti, Plan Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës propozon ndërhyrje në aspektin e

- Rritjes së kapaciteteve të stafit administrativ të Bashkisë Vau i Dejës
- Rritja dhe përmirësimi i transparencës së proceseve të administrimit dhe të vendimarrjes
- Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së publikut në vendimarrje

D.1 - Rritja e kapaciteteve të stafit në Bashkinë Vau i Dejës

| Rezultate të Pritshme | Veprime Konkrete të Propozuara |
|--------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Vlerësimi dhe Riorganizimi administrativ i Bashkisë Vau i Dejës | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja e Analizës Institucionale duke identifikuar mundësitë e riorganizimit të strukturës administrative të Bashkisë në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve si dhe të funksionimit të infrastrukturave publike |
| b. Rritja e kapaciteteve teknike të stafit të Bashkisë | <ol style="list-style-type: none"> Organizimi i trainimeve periodike për rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Vau i Dejës në fushat e menaxhimit të territorit si dhe të shërbimeve publike. |

D2. Komunikimi me Qytetarët dhe Transparenca në vendimarrje

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet konkrete të propozuara |
|------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Shpërndarja zyrtare e informacionit lidhur me aktivitetet dhe projektet në Bashki | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës bashkiake në Vaun e Dejës Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vaun e Dejës (në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme për të gjithë) |
| b. Nxitja e pjesëmarrjes qytetare dhe informimi i tyre në mbledhjet e Këshillit Bashkiak | <ol style="list-style-type: none"> Përgatitja dhe shpërndarja periodike e njoftimeve për organizimin dhe programin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në Vaun e Dejës Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak |

D3. - Buxhetimi me Pjesëmarrje

Duke pasur parasysh nivelin e ulët të investimeve dhe të fondeve në Bashkinë Vau i Dejës, zbatimi i një procesi të plotë dhe të suksesshëm të buxhetimit me pjesëmarrje mund të rezultojë i vështirë. Për këtë arsye, këshillohet që ky proces fillimisht të mundësohet dhe financohet nëpërmjet burimeve alternative të mundshme financiare si psh, donatorë, projekte investimi specifike. Megjithë vështirësitë që paraqiten është e rëndësishme që Bashkia të insistojë për iniciimin dhe zbatimin e suksesshem të këtij procesi të rëndësishëm në territorin e vet administrativ.

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet konkrete të propozuara |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Ngritja e kapaciteteve lokale për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje | 1. Mbështetja dhe mundësimi i trainimeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit përgjegjës të Bashkisë Vau i Dejës lidhur me organizimin e proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje |
| b. Organizimi i aktiviteteve periodike të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Vau i Dejës | 1. Financimi i organizimit vjetor të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Vau i Dejës |

3.4.5 Objektivi F. - Rritja e Mundësive Financiare

Bashkia Vau i Dejës mund të gjenerojë fonde nga:

- ❖ Të ardhurat vendore, të cilat specifikohen në:
 - taksa dhe tarifa të shërbimeve dhe infrastrukturave,
 - taksa të biznesit të vogël
 - taksa e pasurisë (*ndërtesat dhe tokat, trojet dhe bujqësore*)

Lidhur me këto të tre lloje taksash, ajo që u evidentua gjatë punës në Bashkinë Vau i Dejës, është se llogaritja dhe krijimi i një sistemi të besueshëm për vendosjen dhe grumbullimin e taksës së pasurisë në këtë zonë paraqet shumë vështirësi. Sipas komenteve të Bashkisë, mungesa e të dhënave të qarta të rregjistruara lidhur me numrin dhe gjendjen e pasurive të paluatjshme në Bashki, e bën thuajse të pamundur grumbullimin e taksës së pasurisë (tokë dhe objektet). Kjo do të kërkonte një punë të konsiderueshme dhe serioze, e cila do të krijonte bazat për identifikimin e një politike të qartë dhe objektive lidhur me aplikimin e kësaj takse e cila ka premisat për tu kthyer në një nga burimet kryesore të të ardhurave vendore në këtë njësi vendore.

Burime të tjera të ardhurash, si në të gjitha njësitë e tjera vendore janë:

- **Granti i qeverisë qendore**
 - *granti i pakushtëzuar (vjetor)*
 - *grantet e kushtëzuara (në varësi të kërkesave të njësisë vendore/Bashkisë Vau i Dejës/ për investime të ndryshme).*
- **Grante konkurruese nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit**

Këto grante janë të kufizuara deri në kuotën e 25,000 EUR në vit si dhe janë të orientuara në përmirësimin e infrastrukturave rrugore të njësive vendore (rrugët dytësore). Lidhur me këtë pikë, FSHZH ka miratuar një tabelë kriteresh përkatëse për vlerësimin e projekteve të cilat duhet të merren në konsideratë nga njësitë e qeverisjes vendore gjatë përgatitjes së tyre. Që nga Tetori i vitit 2007, Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të asistojë Komitetin Monitorues për përzgjedhjen e fituesve për Grantet Konkurruese, të përbërë nga Ministria e linjës, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme si dhe përfaqesues të shoqatave të njësive vendore.

• **Hua të ndryshme nga bankat e nivelit të dytë**

Në bazë të Ligjit Nr. 9869, datë 04,02,2008 "Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore", Bashkia Vau i Dejës mund të marrë hua afatgjata nga institucione të ndryshme financiare në varësi të kapaciteteve të Bashkisë për të gjeneruar të ardhura nga taksat e veta apo nga grantet e pakushtëzuara. Ajo që duhet pasur parasysh në këtë rast është që kësti vjetor (shërbimi i borxhit) që duhet paguar nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së buxhetit vjetor të Bashkisë Vau i Dejës (grantit i pakushtëzuar + taksat dhe tarifatat lokale).

F1. Rritja e të ardhurave Vendore të Bashkisë Vau i Dejës

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Krijimi dhe konsolidimi i bazë së të dhënave për konsolidimin e nivelit të taksave dhe tarifave në Bashkinë Vau i Dejës | 1. Ngritja e një grupi pune në Bashkinë Vau i Dejës për përpilimin dhe ngritjen e një Baze të Dhënash për listimin e bizneseve, pronave, familjeve si aktiviteteve ekonomike taksapagues. 2. Ngritja e një Sistemi Informacioni në Bashkinë Vau i Dejës nëpërmjet të cilit të evidentohen ndryshimet dhe përmirësimet në politikat fiskale në lidhje me bizneset, pronat (troje dhe tokë bujqësore) në funksion të rritjes së të ardhurave vendore. |
| b. Përmirësimi i kapaciteteve të administratës lokale lidhur me çështjet e menaxhimit financiar | 1. Organizimi i trainimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit të administratës së Bashkisë lidhur me administrimin financiar si dhe të taksave vendore. |

F2. Promovimi dhe rritja e investimeve vendore dhe të huaja në Bashkinë Vau i Dejës

| Rezultatet e Pritshme | Veprime Konkrete të Propozuara |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Përgatitja e materialeve promovuese dhe reklamuese për Bashkinë Vau i Dejës | 1. Krijimi i një materiali të plotë (Profili i Bashkisë) ku të evidentohen të gjitha vlerat dhe karakteristikat specifike natyrore dhe njerëzore të Bashkisë Vau i Dejës, mundësitë për investime, të shoqëruara me materiale hartografike dhe fotot përkatëse. 2. Krijimi dhe konsolidimi i faqes së Internetit së Bashkisë 3. Financimi i emisioneve televizive që trajtojnë mundësitë për zhvillimin e turizmit natyror dhe historik në Bashkinë Vau i Dejës |
| b. Organizimi i evenimenteve të ndryshme me fokus ekonomik | 1. Organizimi i konkurseve dhe panaiereve në nivel rajonal ku të ftohen biznese dhe sipërmarrës të ndryshëm si dhe të promovohen mundësitë dhe potencialet për investime në këtë Bashki |

F3. Rritja e mundësive dhe burimeve të tjera financiare

| Rezultatet e Pritshme | Veprimet Konkrete të Propozuara |
|-------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| a. Përgatitja e Projekt Propozimeve | 2. Përgatitja e një paketë Projekt Propozimesh të cilat adresojnë si përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve por edhe rritjen e investimeve në territorin e Bashkisë. 3. Lobimi dhe organizimi i takimeve me donatorë të ndryshëm duke e përdorur dokumentin e Planit të Zhvillimit si dhe paketën e projekteve që propozohet nëpërmjet tij si provë të përkushtimit dhe profesionalizmit për financime të mundshme dhe bashkëpunim 4. Lobimi dhe Organizimi i takimeve me biznese të ndryshme në nivel rajonal apo kombëtar për të evidentuar mundësitë e investimit në Bashkinë Vau i Dejës |

Një mundësi e mirë për Bashkinë Vau i Dejës janë financimet që mund të sigurohen në kuadër të IPA (Instruments for Pre-Accession Assistance), që është një program për të asistuar vendet që aspirojnë të bashkohen në Bashkimin Europian. Programi IPA ka një shtrirje kohore prej 2007 – 2013 dhe qëllimi kryesor i saj është që të rrisë eficiencën dhe koherencën e fondeve të dhëna për asistencë, brenda të njëjtit kuadër për të gjithë vendet aspirante.


Shqipëria është një nga vendet potenciale për kandidatë për anëtarësim në Bashkimin Europian. Programi IPA përbëhet nga 5 komponentë bazë që janë:

1. mbështetje për procesin e tranzicionit dhe të rritjes institucionale
2. bashkëpunimin ndërkufitar
3. zhvillimin rajonal
4. zhvillimin e burimeve njerëzore
5. zhvillimin rural


Siç vihet re, të gjithë komponentët e programit janë tepër relevante për kontekstin e zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës. Për këtë arsye, administrata e Bashkisë duhet që ti paraprijë proceseve duke rritur kapacitetet e saj dhe nivelin e informacionit për sa i përket këtij programi dhe mundësive që ai paraqet. Pozicioni gjeografik i Vaut të Dejës, profili rural bujqësor si dhe kuadri rajonal në të cilin ndodhet, krijojnë premisa të mira për financime të mundshme, të cilat duhen investiguar.

Për më tepër, është e rëndësishme që të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i mundësive të bashkëpunimit në sfera të ndryshme me njësitë vendore të Bashkisë Vau i Dejës, duke u fokusuar në mundësinë e tërheqjes së financimeve nga fonde dhe programe të reja të Bashkimit Europian për zhvillimin lokal dhe rajonal. Është e nevojshme gjithashtu që të vlerësohet mundësia e krijimit të "shoqatave funksionale", për qëllime të ndryshme si psh: menaxhimi i mbetjeve, furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimeve etj.

Mundësi të tjera për financim për Bashkinë Vau i Dejës përfshijnë grante dhe programe të pritshme nga Bashkimi europian, fonde të ADF, Fonde të Granteve Konkurruese etj. Bashkia ka për detyrë që të rrisë kapacitetet e saj nëpërmjet trainimeve apo ekspertizes teknike për të adresuar sa më shumë financime në territorin e saj.



Kapitulli IV



Zbatimi i Planit Strategjik të Zhvillimit të Propozuar për Bashkinë Vau i Dejës

4.1 Ndërhyrjet Institucionale dhe Ligjore të Propozuara:

Bashkia Vau i Dejës, nëpërmjet Kryetarit dhe administratës vendore, janë përgjegjës kryesorë për zbatimin e Planit Strategjik të Zhvillimit. Për të rritur efikasitetin e këtij procesi është e nevojshme marrja e masave si më poshte:

- Te ngrihet grupi i zbatimit dhe monitorimit të Planit Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Vau i Dejës, brenda strukturës administrative të Bashkisë, i cili do të jetë përgjegjës kryesor për koordinimin dhe zbatimin e nismave dhe aktiviteteve të propozuara në Planin e Veprimit. Në varësi të buxhetit të Bashkisë, grupi mund të përbëhet nga përfaqësues të zyrave të ndryshme të administratës apo edhe nga specialiste të angazhuar rishtazi në këtë strukturë. Në të dy rastet grupi duhet të jetë nën liderhipin e nënkryetarit të Bashkisë apo edhe të vetë kryetarit. Në këtë mënyrë sigurohet vazhdimësia dhe lidhja e Planit Strategjik së Zhvillimit me proceset e planifikimit dhe buxhetimit vjetor.
- Konsolidimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të Zyrës së Koordinimit Zhvillimit në Bashkinë Vau i Dejës, i cili do të angazhohet me përgatitjen e studimeve dhe projekt propozimeve të nevojshme për financim në funksion të aktiviteteve të propozuara sipas çdo fushë.
- Riorganizimi administrativ i Bashkisë Vau i Dejës duke u bazuar në veprimet dhe kërkesat e identifikuara në Planin e Veprimit të propozuar si psh. krijimi i grupeve të punës për përgatitjen e projekt propozimeve, organizimi dhe monitorimi i seminareve apo takimeve me pjesëmarrjen e aktorëve vendore për çështjen e buxhetimit, arsimit, bujqësisë, mjedisit, etj; organizimi dhe moderimi i “shoqërive funksionale” në bashkëpunim me njësitë vendore fqinje etj
- Përmirësimi i bazës së të dhënave territoriale, financiare dhe infrastrukturore në Bashki për ti paraprirë përgatitjes së një serie projektesh apo studimesh të nevojshme për zbatimin e mundshëm të Planit Strategjik të Zhvillimit.
- Rritja e kapaciteteve dhe nivelit të angazhimit të stafit të Bashkisë Vau i Dejës sidomos në aspektin e menaxhimit dhe monitorimit të territorit dhe infrastrukturave fizike nëpërmjet trainimeve të vazhdueshme apo edhe përmirësimit të sistemit të raportimit dhe vlerësimit.
- Institucionalizimi i raporteve periodike të çdo departamenti brenda Bashkisë lidhur me ecurinë dhe monitorimin e zbatimit të Planit Strategjik të Zhvillimit.

4.2. Plani I Veprimit

4.2.1 Plani i Veprimit për vitin 2008

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e Propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-----------------------------------------------|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| C-Zhvillimi i Infrastrukturave dhe Shërbimeve | C1b2 | Përgatitja e Detyrave të Projektimit nga ana e Bashkisë Vau i Dejës për ti paraprirë përgatitjes së Projekteve Teknike për akset rrugore. | Zyra e Urbanistikës | 0 Lek | Përgatitja e Detyrave të Projektimit duhet të marrë në konsideratë profilet e propozuara në Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit |
| F-Rritja e të Ardhurave Vendore | F1b1 | Organizimi i trainimeve për menaxhimin financiar në Bashkinë Vau i Dejës, | Bashkia Vau i Dejës, Intercooperation, URI | | |

4.2.2 Plani i Veprimit per vitin 2009

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|--------------------------|---------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A1b1 | Organizimi i takimeve me fermerët e Vaut të Dejës për specifikimin e qartë dhe realist të mundësive të prodhimit të kulturave bujqësore në këtë Bashki | Zyra e Koordinim Zhvillimit, eksperte të bujqësisë apo blegtorisë. | 200,000 Lek | Takimet mund të organizohen në ambientet e Bashkisë apo në terren, nëpërmjet asistencës së ekspertëve të bujqësisë, si dhe me asistencën e Qarkut Shkodër. |
| | A1b2 | Përgatitja e një studimi teknik ku të evidentohen kapacitetet prodhuese bujqësore në zonen e Vaut të Dejës, e fokusuar në zonën perëndimore fushore. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të bujqësisë apo blegtorisë. | 200,000 Lek | Dokumenti duhet të përmbajë një vlerësim të potencialeve prodhuese të zonës si dhe asistencën që mund të ofrojë Bashkia për këtë proces |
| | A1c1 | Ngritja dhe konsolidimi i një grupi punë të përbashkët (Bashkia Vau i Dejës, Drejtoria Rajonale e bujqësisë Shkodër, fermerët) që do të jetë përgjegjës për organizimin dhe menaxhimin e procesit të mbështetjes ndaj zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të bujqësisë apo blegtorisë në Qark apo në Shkodër | 0 Lek | Grupi do të mbikqyrë proceset e kontaktit me fermerët vendas, hartimin e studimit të fizibilitetit, si dhe do të mund të llojë për rritjen e mundësisë së investimeve në këtë sektor |
| B-Menaxhimi i Territorit | B1a2 | Përgatitja e standave të posaçme në ambientet e brendshme të Bashkisë Vau i Dejës ku të paraqiten skemat hapësinore – hartat e Planit Përgjithshëm Rregullues të Propozuar, si dhe kufijtë e lejuar të ndërtimeve në të ardhmen (vijat e verdha të qytetit të Vaut të Dejës si dhe të fshatrave) | Zyra e Urbanistikës | 50,000 Lek | Stendat duhet të jenë të përmasave të konsiderueshme në mënyrë që të identifikojnë qartë konturet e zhvillimit dhe format e tyre |
| | B1c1 | Përgatitja e një plani pune për ndërhyrjen në zonat prioritare që do të studiohen nga drejtoria e urbanistikës së Bashkisë Vau i Dejës, objekti i të cilit është përgatitja e një pakete projektsh teknike apo Studimeve Urbanistike Pjesore | Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës | 0 Lek | Plani i punës do të miratohet nga Këshilli Vendor i Bashkisë |
| | B1b1 | Përgatitja e Termave të Referencës apo Projekteve teknike konkrete të akteve të reja rrugore të propozuara apo të ndërhyrjeve në rrjetin e infrastrukturave sekondare në varësi të skemës hapësinore të propozuar në Planin i Përgjithshëm Rregullues | Zyra e Urbanistikës | 1,000,000 Lek | Qëllimi i projekteve është që të legjitimojë konturet e rrugëve duke orientuar në mënyrë definitive mënyrën e ndërtimit të objekteve të reja në qytet |
| | B2a1 | Konsolidimin e zyrës së Inspektoriatit të Ndërtimit në Bashkinë Vau i Dejës, sipas përcaktimeve të Ligjit të ri Nr. 9780, dt. 16,7,2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit". | Zyra e Financës, Zyra e Urbanistikës, ekspertë të fushës | 300,000 Lek | Proçesi do të përfshijë pajisjen e zyrës me bazën e nevojshme të informacionit, përgatitjen e një plani pune si dhe identifikimi i nevojave afatgjata për investime. |
| | B2a2 | Identifikimi i nevojave për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Inspektoriatit të Ndërtimit në Bashkinë Vau i Dejës duke qartësuar edhe kërkesat për financime të mëtejshme. | Zyra e Urbanistikës | 0 Lek | Proçesi do të përmbledhet në formën e një raporti të posaçëm, ku gjetjet e tij të shërbejnë për organizimin e aktiviteteve të nevojshme, si kurse, trainime etj. |
| | C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe i Infrastrukturave | C1a1 | Pikëtimi në terren i akteve dhe profileve rrugore të propozuara në Planin Rregullues të Përgjithshëm të qytetit dhe në hartat e Planit Strategjik të Zhvillimit, duke përcaktuar vijat e ndërtimit si dhe akset e rrugëve të propozuara | Zyra e Urbanistikës, eksperte dhe topografë | 300,000 Lek |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe i Infrastruktura | C1b1 | Përgatitja e Projekt Propozimeve të posaçme duke ia adresuar donatoreve potenciale, për financimin e procesit të hartimit të Projekteve Teknike në lidhje me rristurimin dhe përmirësimet fizike të rrugëve të reja të propozuara | Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës, etj | 100,000 Lek | Qëllimi i konceptimit si një proces të veçantë është rritja e mundësive për gjenerim fondesh, duke qenë se shumë nga projektet propozimet për fonde nuk miratohen për mangësi teknike në propozim. |
| | C1b2 | Përgatitja e Detyrave të Projektimit nga ana e Bashkisë Vau i Dejës për ti paraprirë përgatitjes së Projekteve Teknike për akset rrugore. | Zyra e Urbanistikës | 0 Lek | |
| | C1c1 | Përgatitja dhe miratimi i një plani ndërrhyrjesh përmirësuese në rrjetin rrugor të qytetit si dhe të gjithë fshatrave të zonës perëndimore të Bashkisë Vau i Dejës. | Zyra e Urbanistikës, Zyra e K. Zhvillimit | 0 Lek | Plani duhet të miratohet në Këshillin Lokal në mënyrë që të përfshihet në skemat e buxhetimit për vitet në vijim. |
| | C2a1 | Kryerja e një inventari të plotë teknik ku të identifikohen të gjitha asetet fizike dhe kaptalet që disponon Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Shërbimeve, inxhinierë, ekspertë | 100,000 Lek | |
| | C3a1 | Vlerësimi i gjendjes egzistuese të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbeturinave urbane në Bashkinë Vau i Dejës, duke specifikuar sasishtë ditore të mbetjeve të prodhuara, llojet e këtyre mbetjeve, format e grumbullimit, kostot përkatëse si dhe tarifat e shërbimit | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit, Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë mjedisorë | 100,000 Lek | Qëllimi i këtij procesi është që të përgatisë bazen e nevojshme informative për ndërmarrjen e hapave cilësore drejt përmirësimit të shërbimit të pastrimit dhe gjelbërimit në Bashki. |
| | C6a2 | Përmirësimi i ndriçimit rrugor në akset kryesore të qytetit të Vaut të Dejës | Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës, | 200,000 Lek | |
| D-Qeverisja e Mirë | D1a1 | Përgatitja e Analizës Institucionale duke identifikuar mundësitë e riorganizimit të strukturës administrative të Bashkisë në funksion të rritjes së efikasitetit të shërbimeve si dhe të funksionimit të infrastrukturave publike | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të posaçëm | 200,000 Lek | Skema e përfutur në fund të propozimit duhet të miratohet në Këshillin Vendor të Bashkisë si dhe të identifikojë ndryshimet e duhura në nivel institucional dhe administrativ të Bashkisë |
| | D1b1 | Organizimi i trainimeve periodike për rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Vau i Dejës në fushat e menaxhimit të territorit si dhe të shërbimeve publike. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të posaçëm | 200,000 Lek | Trainimet duhet të fokusohen në format e zbrëthimit të Planit Rregullues, dhënien e lejeve të ndërtimit, si dhe kontrollin e zhvillimit |
| | D2a1 | Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës Bashkiake në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 100,000 Lek | Gazeta e Bashkisë duhet të botohet çdo vit, në bazë mujore. |
| | D2a2 | Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e Bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të zyrave të ndryshme | 0 Lek | Raporti duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në arritjen e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të identifikojë masat e nevojshme për përmirësim të situatës |
| | D2b1 | Përgatitja dhe shpërndarja periodike e njoftimeve për organizimin dhe programin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 10,000 Lek | Qëllimi është që të rritet niveli i transparencës për sa i përket vendimarrjes në Bashkinë Vau i Dejës. Ky aktivitet duhet të organizohet çdo vit që përfshin Planin Strategjik të Zhvillimit |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|---------------------------------|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| D-Qeverisja e Mirë | D2b2 | Përgatitja dhe publikimi i rezultateve të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 10,000 Lek | Rezultate e mbledhjeve të Këshillit Vendor duhet të publikohen në gazetën e Bashkisë |
| F-Rritja e të Ardhurave Vendore | F1a1 | Ngritja e një grupi pune në Bashki për përpilimin dhe konsolidimin e një Baze të Dhënash për listimin e bizneseve, pronave, familjeve si dhe aktiviteteve ekonomike taksapaguese | Zyra e Financës, Zyra e Shërbimeve | 0 Lek | |
| | F3a2 | Lobimi dhe organizimi i takimeve me donatorë të ndryshëm duke e përdorur dokumentarin e PSZH si dhe paketën e projekteve që propozohet për mundësimin e financimeve të ndryshme | Kryetari i Bashkisë, Zyra e Koordinim Zhvillimit, | 0 Lek | |

4.2.3 Plani i Veprimit për vitin 2010

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A1a1 | Përcaktimi i një pakete ndihme financiare të përvitshme për fermerët vendas në Bashkinë Vau i Dejës me miratimin e Këshillit Vendor, si dhe vlerësimi i mundësive për financim nga ana e aktorëve të ndryshëm financiar apo bankave të nivelit të dytë. | Zyra e financës në Bashki, ekspertë të financës, ekspertë të bujqësisë etj | 0 Lek | Aktiviteti i propozuar ka të bëjë vetëm me procesin. Sasia e financimit do të varet nga analiza e eksperteve dhe nga miratimi i paketës nga Këshilli i Bashkisë |
| | A1a2 | Përgatitja e Projekteve të gatshme teknike për ndërhyrjet fizike në infrastrukturën bujqësore apo në parcelat e kultivuara në fshatrat e Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Urbanistikës, ekspertë të projektimit | 300,000 Lek | Qëllimi i projekteve është që ti paraprijë financimeve të mundshme nga qeveria qendrore apo nga fondet e financimit të ndryshëm |
| | A1b2 | Përgatitja e një studimi teknik ku të evidentohen kapacitetet prodhuese bujqësore në zonën e Vaut të Dejës, e fokusuar në zonën perëndimore fushore. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të bujqësisë apo blegtorisë. | 200,000 Lek | Dokumenti duhet të përmbajë një vlerësim të potencialeve prodhuese të zonës si dhe asistencën që mund të ofrojë Bashkia për këtë proces |
| | A1c2 | Organizimi i debateve të hapura apo forumeve lidhur me nevojat dhe prioritetet për investime në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të bujqësisë apo blegtorisë | 100,000 Lek | Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që në mbështetje të takimeve me fermerët lokale të zgjerojë nivelin e ndërgjegjësimit të aktorëve lokale dhe biznesit të interesuar për investim |
| | A3a1 | Përgatitja e Studimeve Pjesore të Detajuara për zonën e korridorit ekonomik të përmendur përgjatë rrugës kryesore Shelqet Mjedë | Zyra e Urbanistikës, ekspertë të posaçëm | 500,000 Lek | Qëllimi i këtyre studimeve është që të promovojnë dhe të orientojnë investimet në këtë zonë. Gjithashtu këto studime do të shërbejnë edhe si bazë e rëndësishme për përgatitjen e Projekt Propozimeve për financim |
| | A4a1 | Organizimi i takimeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave si dhe me Qarkun Shkodër lidhur me mundësinë e kthimit të zonës së magazinave në Mjedë në zonë të lirë ekonomike. | Kryetari i Bashkisë, Zyra e Koordinim Zhvillimit | 0 Lek | Qëllimi i takimeve është që të promovojë rivitalizimin e zonës së degraduar të magazinave të hekurudhës, në një zonë me përdorime ekonomike mikse dhe të zhvilluar. |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| B-Menaxhimi i Territorit | B1a1 | Përgatitja dhe vendosja e tabelave të reja informuese në zonat e konsolidimit urban në të gjithë territorin e Bashkisë | Zyra e Urbanistikës | 200,000 Lek | Tabelat do të shërbejnë për informimin e banorëve për strukturën hapësinore të propozuar, si dhe për orientimin e zhvillimeve urbane në të ardhmen. |
| | B1b1 | Përgatitja e Termave të Referencës apo Projekteve teknike konkrete të akseve të reja rrugore të propozuara apo të ndërhyrjeve në rrjetin e infrastrukturave sekondare në varësi të skemës hapësinore të propozuar në Planin Rregullues | Zyra e Urbanistikës | 1,000,000 Lek | Qëllimi i projekteve është që të legjitimojë konturet e rrugëve duke orientuar në mënyrë definitive mënyrën e ndërtimit të objekteve të reja në qytet |
| | B2b1 | Përgatitja dhe miratimi në Këshillin Vendor të Bashkisë Vau i Dejës të një pakete masash penalizuese për ndërtimet në tokat bujqësore nën administrimin e kësaj bashkie. | Zyra e Urbanistikës, Zyra e K. Zhvillimit, ekspertë ligjorë. | 0 Lek | Duke shfrytëzuar kompetencat e përcaktuara me ligj, Bashkia ka të drejtë të identifikojë taksa të posaçme të cilat adresojnë zgjidhjen e problemeve të ndryshme në territorin e vet. |
| | B2b2 | Përgatitja e materialeve informuese për banorët e fshatrave të Vaut të Dejës lidhur me masat që do të merren në rastet e ndërtimeve pa leje. | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 50,000 Lek | Materialet mund të jenë në formën e fletëpalosjeve apo të standave të posaçme |
| | B3a1 | Hartimi i një studimi teknik hartografik ku të specifikohen zonat e ndjeshme mjedisore në territorin e Bashkisë Vau i Dejës si dhe përcaktimi i nevojave për ndërhyrje fizike përmirësuese | Zyra e Urbanistikës, Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë mjedisi etj | 300,000 Lek | Studimi duhet të marrë në konsideratë propozimet për Planin e Ri Rregullues të qytetit si dhe propozimet territoriale të PSZH. Gjithashtu një nga objektivat e studimit duhet të jetë përmirësimi i gjendjes mjedisore në mbështetje të zhvillimit të turizmit natyror dhe liqenor. |
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C1a1 | Pikëtimi në terren i akseve dhe profileve rrugore të propozuara në Planin Rregullues të Përgjithshëm të qytetit dhe në hartat e Planit Strategjik të Zhvillimit, duke përcaktuar vijat e ndërtimit si dhe akset e rrugëve të propozuara | Zyra e Urbanistikës, ekspertë dhe topografë | 300,000 Lek | |
| | C1c2 | Fillimi i punës për rehabilitimin bulevardit kryesor të qytetit të Vaut të Dejës si dhe të rrugëve të tjera kryesore sipas skemës së propozuar në Planin e Përgjithshëm Rregullues | Zyra e Urbanistikës, Firmë ndërtimi | 1,000,000 Lek | Proçesi do të përfshijë, përgatitjen e një studimi teknik të detajuar nga ana e Zyrës së Urbanistikës, pikëtimin në terren të kontureve të reja të rrugës, lajmërimin e objekteve egzistuese për prishjen e tyre, përgatitjen e një plani pune të përshtatshëm. |
| | C2a2 | Përgatitja e një skeme përmirësimi dhe investimi për logjistikën dhe zyrat e Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Ujësjellës Kanalizimeve, Zyra e Shërbimeve në Bashki, | 0 Lek | Aktiviteti konsiston në përgatitjen e një plani pune ku të identifikohen hapat konkrete për përmirësimin e gjendjes si dhe investimet e nevojshme. |
| | C2a3 | Alokimi dhe miratimi në Këshillin Vendor të Bashkisë të financimit për përmirësimin e gjendjes teknike të zyrës së Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve | Zyra e Ujësjellës Kanalizimeve, Zyra e Shërbimeve në Bashki, | 0 Lek | Në këtë mënyrë, ky proçes do të bëhet objekt i diskutimeve për buxhetimin vjetor në Bashki. |
| | C2b2 | Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e përmirësimin të ujësjellës kanalizimeve për qytetin dhe fshatrat e Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Ujësjellës Kanalizimeve, Zyra Urbanistikës, ekspertë teknikë | 0 Lek | Këto propozime mund të adresojnë banka të nivelit të dytë, qeverinë qendrore apo donatorë të ndryshëm që operojnë në Shqipëri. |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C3a2 | Përgatitja e një Plani të ri të Menaxhimit të Mbeturinave duke u fokusuar në uljen e kostove të grumbullimit dhe transportit të mbetjeve, rritjen e të ardhurave nga tarifat e pastrimit si dhe rritjen e performancës së shërbimit. | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit, Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë mjedisorë | 100,000 Lek | Plani i propozuar duhet të bazohet në arritjen e qëndrueshmërisë së shërbimit; pra ai të mbulohet nga të ardhurat lokale të taksës për mbeturinat |
| | C4a1 | Hartimi i një vlerësimi teknik ku të evidentohet gjendja egzistuese e shkollave në territorin e Bashkisë, nevojat për riparime dhe përmirësime fizike të tyre | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të arsimit, perfaqesues të shkollave | 100,000 Lek | Ne fund të këtij procesi duhet të përgatitet një inventar i plotë i nevojave për ndërhyrje fizike në të gjitha shkollat dhe kopshtet e Vaut të Dejës. Inventari duhet të firmoset nga Këshilli Vendor, duke hapur rrugë për buxhetim dhe investim |
| | C5a1 | Përgatitja e Projekteve teknike për rehabilitimin e gjelberimit të rrugëve egzistuese në Bashkinë Vau i Dejës në përputhje me propozimet e Planit të Përgjithshëm Rregullues dhe skemës rrugore të paraqitur në hartat e PSZH | Zyra e Urbanistikës në Bashki, ekspertë teknikë | 100,000 Lek | Blloku i projekteve do të miratohet nga Këshilli Vendor duke hapur rrugën për investime dhe financime |
| | C6a2 | Përmirësimi i ndriçimit rrugor në akset kryesore të qytetit të Vaut të Dejës | Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës, | 200,000 Lek | |
| | C8a2 | Organizimi dhe financimi i ndërhyrjeve përmirësuese përgjatë rrugëve kryesore të qytetit të Vaut të Dejës si dhe fshatrave | Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës, | 300,000 Lek | |
| D-Qeverisja e Mirë | D2a1 | Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës bashkiake në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 100,000 Lek | Gazeta e Bashkisë duhet të botohet çdo vit, në bazë mujore. |
| | D2a2 | Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e Bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të zyrave të ndryshme | 0 Lek | Raporti duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në arritjen e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të identifikojë masat e nevojshme për përmirësim të situatës |
| | D3a1 | Mbështetja dhe mundësimi i trainimeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit përgjegjës të Bashkisë Vau i Dejës lidhur me organizimin e proceseve të buxhetimit me pjesëmarrje | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të posaçëm | 100,000 Lek | Zyra e Koordinimit mund të përcaktojë një metodologji të posaçme duke u bazuar në eksperiencat e shumë njësive vendore si dhe në asistencën e Intercooperation Albania |
| F-Rritja e të ardhurave lokale | F1a2 | Ngritja e një Sistemi Informacioni në Bashkinë Vau i Dejës nëpërmjet të cilit të evidentohen ndryshimet dhe përmirësimet në politikat fiskale në lidhje me bizneset, pronat (troje dhe tokë bujqësore) në funksion të rritjes së të ardhurave vendore | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të informacionit | 300,000 Lek | Qëllimi i këtij Sistemi është që të lehtësojë menaxhimin fiskal të Bashkisë, duke identifikuar politikat e nevojshme fiskale për rritjen e të ardhurave lokale. |
| | F2a2 | Krijimi dhe konsolidimi i faqes së Internetit së Bashkisë Vau i Dejës | Ekspertë informacioni | 200,000 Lek | Faqja e internetit duhet të mirëmbahet dhe të plotësohet me informacion të përditësuar në baza mujore. |
| | F3a1 | Përgatitja e një pakete Projekt Propozimesh të cilat adresojnë si përmirësimin e infrastrukturave dhe shërbimeve por edhe rritjen e investimeve në territorin e Bashkisë. | Kryetari i Bashkisë, Zyra e Koordinim Zhvillimit etj | 100,000 Lek | |
| | F3a2 | Lobimi dhe organizimi i takimeve me donatorë të ndryshëm duke përdorur dokumentarin e Strategjisë së Zhvillimit si dhe paketën e projekteve që propozohet për mundësimin e financimeve të ndryshme | Kryetari i Bashkisë, Zyra e Koordinim Zhvillimit, | 0 Lek | |
| | F3a3 | Lobimi dhe Organizimi i takimeve me biznese të ndryshme në nivel rajonal apo kombëtar për të evidentuar mundësitë e investimit në Bashkinë Vau i Dejës | Kryetari i Bashkisë, Zyra e Koordinim Zhvillimit etj | 100,000 Lek | Takimet mund të organizohen edhe në vitet në vazhdim, të propozuar në Planin Strategjik të Zhvillimit |

4.2.4 Plani i Veprimit për vitin 2011

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A1a3 | Mbështetja ndaj proceseve për ngritjen e kapaciteteve për fermerët vendas në Vau i Dejës me qëllim përmirësimin e efikasitetit të tyre në punë dhe prodhimtari | Zyra e Koordinimit Zhvillimit në Bashki, ekspertë të fushës | 200,000 Lek | Këto procese mund të përfshijnë organizim trainimesh, apo asistencë direkte gjatë proceseve bujqësore. Bashkia dhe Zyra e Koordinimit Zhvillimit është përgjegjëse për financimin dhe moderimin e këtyre aktiviteteve |
| | A1c2 | Organizimi i debateve të hapura apo forumeve lidhur me nevojat dhe prioritetet për investime në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë | Zyra e Koordinimit Zhvillimit, ekspertë të bujqësisë apo blegtorisë | 100,000 Lek | Qëllimi i këtyre aktiviteteve është që në mbështetje të takimeve me fermerët të zgjerohet niveli i ndërgjegjesimit të aktorëve vendorë dhe biznesit të interesuar për investim |
| | A1c3 | Hartimi i një programi / axhendë ndërhyrjesh fizike në sistemet e tokave, ujitjes dhe kullimit | Zyra e Urbanistikës në Bashki, ekspertë të bujqësisë | 50,000 Lek | Qëllimi i programit është që gjatë përgatitjes së buxhetit vjetor në nivel lokal të merret parasysh edhe rehabilitimi i rrjetit të infrastrukturave bujqësore. |
| | A2a1 | Përgatitja e një axhende – programi pune për organizimin e aktiviteteve turistike promovuese në bregun e Liqenit Artificial të Vaut të Dejës | Zyra e Koordinimit Zhvillimit, ekspertë të fushës së turizmit | 50,000 Lek | Aktivitetet e propozuara në këtë axhendë do të konsiderohen gjatë përgatitjes së projekt buxhetit si dhe në përgatitjen e projekt propozimit për financime |
| | A2b3 | Organizimi i aktiviteteve periodike të pastrimit dhe gjelberimit të zonës së plazheve të liqenit artificial | Ndërmarrja e pastrimit dhe struktura e posaçme për liqenin | 200,000 Lek | Aktivitetet do të konsistojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për plazhin sezonal përgjatë brigjeve të liqenit artificial |
| | A3a2 | Përgatitja e Projekteve Teknike të infrastrukturave (rugë ndihmëse, ujësjellëse dhe kanalizime) për korridorin ekonomik Shelqet Mjedë | Zyra e Urbanistikës, ekspertë të posaçëm | 1,000,000 Lek | Këto projekte do të shërbejnë për promovimin e propozimeve për investime nga ana e Bashkisë dhe investitorëve të interesuar |
| | A3b1 | Përgatitja e një Plani Pune lidhur me investimet dhe ndërhyrjet fizike në këtë korridor ekonomik | Zyra e Koordinimit Zhvillimit, | 0 Lek | Plani, i cili do të miratohet në Këshillin Vendor të Bashkisë për të marrë vlerën ligjore do të shërbejë gjatë diskutimeve për buxhetin vjetor të njësisë. |
| | A4a2 | Organizimi i takimeve periodike me zhvillues apo operatorë ekonomike për investime të mundshme në këtë zonë të lirë ekonomike | Zyra e Koordinimit Zhvillimit | 50,000 Lek | Takimet duhet të mbështeten gjithashtu në studimet e kryera nga ana e Bashkisë si dhe në mbështetjen që ajo ofron për biznesin. |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A4b1 | Përgatitja e një vlerësimi teknik ku të identifikohen qartë nevojat për investime në infrastrukturë në këtë zonë | Zyra e Urbanistikës, ekspertë | 50,000 Lek | Në baze të këtij vlerësimi teknik, bashkia dhe zyra e urbanistikës do të ketë mundësi që të përgatisë projekte të ndryshme apo Projekt Propozime për financim. |
| B-Menaxhimi i Territorit | B2c1 | Përgatitja e një Vlerësimi Teknik që të përcaktojë një paketë taksash të posaçme për ndërtimet egzistuese në territoret bujqësore të Bashkisë Vau i Dejës (dhe në territoret urbane), në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në Ligjin për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë ligjorë etj | 100,000 Lek | Paketa e taksave, që miratohet në fund nga Këshilli Vendor, ka për objektiv rritjen e mundësive financiare të Bashkisë Vau i Dejës për të investuar në studime urbane dhe investime fizike për rehabilitimin e zonave të reja që kanë mungesa në infrastruktura dhe shërbime. |
| | B2c2 | Organizimi i trainimeve për rritjen e kapaciteteve të stafit të Bashkisë Vau i Dejës për të rritur nivelin e grumbullimit të taksës së pronësise si dhe menaxhimin e tyre | Zyra e Koordinim Zhvillimit, Zyra e Urbanistikës | 200,000 Lek | |
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C2b1 | Përgatitja e Projekteve Teknike për përmirësimin e rrjeteve të shpërndarjes së ujit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në përputhje me propozimet për organizimin dhe konsolidimin e zonave urbane të qytetit dhe të fshatrave të Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Ujesjelles Kanalizimeve, Zyra Urbanistikës, ekspertë teknikë, | 500,000 Lek | Projektet do të fokusohen në propozimet e bëra në Planin e Përgjithshme Rregullues në strukturën urbane si dhe në rrjetin rrugor. |
| | C2c1 | Financimi dhe organizimi i trainimeve të nevojshme për stafin e ndërmarrjes së Ujesjelles Kanalizimeve për përmirësimin e efijencës dhe shërbimit | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë | 200,000 Lek | Temat e trainimit mund të fokusohen në aspektet e menaxhimit të shërbimit, rritjes së të ardhurave dhe monitorimit të efijencës |
| | C3b1 | Hartimi i një Studimi Teknik për përcaktimin dhe vlerësimin e vendi për ngritjen e një landfilli inxhinierik për depozitimin dhe trajtimin e mbeturinave urbane në territorin e Bashkisë | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit, Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë mjedisorë | 200,000 Lek | Landfilli i propozuar duhet të konceptohet në mbështetje të një skemë rajonale me afatgjatë, të depozitimit të mbetjeve në Bushat. |
| | C4b1 | Përgatitja e Projekteve Teknike nga ana e zyrës së projektimit në Bashki për formën dhe mënyrat e ndërhyrjeve fizike në kopshte dhe shkolla | Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë | 200,000 Lek | Qëllimi i projekteve është që të përgatisin bazën e nevojshme teknike që mundëson investimet dhe ndërhyrjet konkrete |
| | C5a2 | Përgatitja e Projektit Teknik për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Parkut Periferik të qytetit të Vaut të Dejës. | Zyra e Urbanistikës në Bashki, ekspertë teknikë | 500,000 Lek | |
| | C6a1 | Përgatitja e Projekteve Teknike për rehabilitimin dhe përmirësimin e ndriçimit rrugor përgjate rrugëve kryesore të qytetit të Vaut të Dejës bazuar në specifikimet teknike të dhëna në Planin e Përgjithshëm Rregullues | Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë | 300,000 Lek | Paketa e projekteve duhet të shërbejë për propozime të ndryshme për financim. Propozimet mund të përgatiten nga Zyra e Koordinim Zhvillimit |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C6b1 | Përgatitja e projekteve teknike për ndriçimin e rrugëve të brendshme të fshatrave të zonës perëndimore të Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë | 300,000 Lek | Projektet teknike duhet të respektojnë profilet e propozuara në materialet hartografike të akteve kryesore rrugore |
| | C6b2 | Përgatitja e projekt propozimeve për financimin e ndriçimit rrugor në fshatrat e Bashkisë. | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 0 Lek | Edhe pse Bashkia Vau i Dejës ka pak mundësi për investime fizike, qëllimi i Projekt Propozimeve është të rrisë mundësitë e saj për financime nga donatorë te ndryshëm |
| | C8a1 | Përgatitja e planit vjetor të investimeve lidhur me zbulimin dhe përmirësimin estetik të zonave urbane të qytetit si dhe zonat e konsolidimit urban në fshatrat e Bashkisë | Zyra e Urbanistikës, Zyra e K. Zhvillimit | 0 Lek | Pas përgatitjes, Plani duhet të miratohet në Këshillin Vendor të Bashkisë. Proçesi duhet të adresojë përmirësimin e imazhit të qytetit si dhe të zonave përreth |
| | C8a2 | Organizimi dhe financimi i ndërhyrjeve përmirësuese përgjatë rrugëve kryesore të qytetit të Vaut të Dejës si dhe fshatrave | Zyra e Shërbimeve, Zyra e Urbanistikës, | 300,000 Lek | |
| D-Qeverisja e Mirë | D2a1 | Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës Bashkiake në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 100,000 Lek | Gazeta e Bashkisë duhet të botohet çdo vit, në bazë mujore. |
| | D2a2 | Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të zyrave të ndryshme | 0 Lek | Raporti duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në arrijten e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të identifikojë masat e nevojshme për përmirësim të situatës |
| | D3b1 | Financimi i organizimit vjetor të Buxhetimit me Pjesëmarrje në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të posaçëm | 200,000 Lek | Që në fillim të vitit, Bashkia Vau i Dejës si dhe Këshilli Vendor duhet të miratojnë paketën financiare që do të përfshihet në buxhetimin me pjesëmarrje |
| F-Rritja e të Ardhurave Vendore | F2a1 | Krijimi i një materiali të plotë (Profili i Bashkisë) ku të evidentohen të gjitha vlerat dhe karakteristikat specifike natyrore dhe njerëzore të Bashkisë Vau i Dejës, mundësitë për investime, të shoqëruara me materiale hartografike dhe fotot përkatëse. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të informacionit | 300,000 Lek | Materiali duhet të promovojë mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore si dhe të turizmit liqenor |
| | F3a3 | Lobimi dhe Organizimi i takimeve me biznese të ndryshme në nivel rajonal apo kombëtar për të evidentuar mundësitë e investimit në Bashkinë Vau i Dejës | Kryetari i Bashkisë, Zyra e Koordinim Zhvillimit etj | 100,000 Lek | Takimet mund të organizohen edhe në vitet në vazhdim, tv propozuar ne Planin Strategjik të Zhvillimit |

4.2.5 Plani i Veprimit për vitin 2012

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------|------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A1a3 | Mbështetja ndaj proceseve për ngritjen e kapaciteteve për fermerët vendas në Vau i Dejës me qëllim përmirësimin e efikasitetit të tyre në punë dhe prodhimtarisë | Zyra e Koordinimit Zhvillimit në Bashki, ekspertë të fushës | 200,000 Lek | Këto procese mund të përfshijnë organizim trainimesh, apo asistencë direkte gjatë proceseve bujqësore. Bashkia dhe Zyra e Koordinimit Zhvillimit është përgjegjëse për financimin dhe moderimin e këtyre aktiviteteve |
| | A2a2 | Konsolidimi i bashkëpunimit me Komunën Guri i Zi për institucionalizimin e ngjarjeve apo festave promovuese për liqenin e Vaut të Dejës dhe të pikës historike të Shurdhahut, me investimet e Bashkisë ku ftohen edhe operatorë të ndryshëm ekonomike për bashkëpunim | Kryetarët e Bashkisë dhe të Komunës, Zyrat përkatëse të Koordinimit Zhvillimit | 0 Lek | Kjo marreveshje do të institucionalizojë çështje që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e qëndrueshëm të bregut të Liqenit të Vaut të Dejës si dhe marrjes së veprimeve të përbashkëta për zhvillimin e turizmit liqenor |
| | A2b1 | Hartimi i një studimi teknik i cili evidenton ndërhyrjet e nevojshme fizike përmirësuese në zonën e brigjeve të plazheve të liqenit artificial | Zyra e Koordinimit Zhvillimit, ekspertë të turizmit, dhe të infrastrukturave | 100,000 Lek | Studimi do të shërbejë për identifikimin e aktiviteteve dhe projekteve teknike që duhet të kryhen në zonën e liqenit për zhvillimin e turizmit. Këto aktivitete mund të merren në konsideratë në proceset e buxhetimit si dhe përgatitjes së Projekt Propozimeve për financim. |
| | A2b2 | Ngritja e strukturave të posaçme brenda Bashkisë Vau i Dejës përgjegjëse për të menaxhuar dhe kontrolluar zonën e plazheve përgjate brigjeve të liqenit artificial | Zyra e Koordinimit Zhvillimit, ekspertë të turizmit, dhe të infrastrukturave | 0 Lek | Kjo strukturë brenda Bashkisë Vau i Dejës do të jetë përgjegjëse edhe për menaxhimin dhe koordinimin e proceseve dhe aktiviteteve turistike promovuese të identifikuar në studimin teknik të mësipërm |
| | A2b3 | Organizimi i aktiviteteve periodike të pastrimit dhe gjelbërimit të zonës së plazheve të liqenit artificial | Ndërmarrja e pastrimit dhe struktura e posaçme për liqenin | 200,000 Lek | Aktivitetet do të konsistojnë në krijimin e kushteve të përshtatshme për plazhin sezonal përgjate brigjeve të liqenit artificial |
| | A2c1 | Përgatitja e materialeve promovuese të liqenit artificial të Vaut të Dejës si psh, postera, broshura apo fletëpalosje | Zyra e Koordinimit Zhvillimit, ekspertë të turizmit | 100,000 Lek | Ky proces duhet të fillojë pasi të jenë kryer një pjesë e mirë e aktiviteteve paraprake promovuese dhe përmirësuese |
| | A2c3 | Përmirësimi periodik të faqes zyrtare në internet për Liqenin Artificial të Vaut të Dejës | Zyra e Koordinimit Zhvillimit si dhe ekspertë kompjuterikë | 100,000 Lek | Promovimi i zonës liqenore duhet të përmbajë imazhe të zonës, të dhëna fizike dhe infrastrukturorë etj. |
| | A4b2 | Në bazë të vlerësimit teknik, përgatitja e projekteve konkretë të infrastrukturave dhe shërbimeve të nevojshme për zonën | Zyra e Urbanistikës, ekspertë projektimi | 500,000 Lek | |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|-------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A4b3 | Kryerja e investimeve të vogla periodike për infrastrukturën fizike në zonë | Bashkia Vau i Dejës | 1,000,000 Lek | Në këtë proces, Bashkia mund të bashkëpunojë edhe me investitorë të interesuar, duke rritur kështu nivelin total të investimit. |
| | A4b4 | Përgatitja e Projekt Propozimeve për financim për zhvillimin e zonës ekonomike si dhe përmirësimin e infrastrukturave të nevojshme. | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të ndryshëm | 100,000 Lek | Propozimet mund të adresojnë grantet qeveritare, institucionet donatorë si dhe projektet në Programin IPA, grantet konkurruese etj |
| B-Menaxhimi i Territorit | B3b1 | Pastrimi i zonave urbane dhe i kanaleve të ujit nga mbeturinat e pagrumbulluara si dhe depozitimi i tyre në pikën aktuale të grumbullimit | Bashkia, firmë e kontraktuar. | 1,000,000 Lek | Buxheti i propozuar mund të konsiderohet në shifra minimale, ndërkohe që Bashkia mund të eksplorojë mundësi të tjera financimi në nivel qendror dhe rajonal. Kadri mbështetës duhet të jetë përmirësimi i imazhit të Bashkisë, në lidhje me zhvillimin e turizmit |
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C2b1 | Përgatitja e Projekteve Teknike për përmirësimin e rrjeteve të shpërndarjes së ujit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza në përputhje me propozimet për organizimin dhe konsolidimin e zonave urbane të qytetit dhe të fshatrave të Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Ujësjellës Kanalizimeve, Zyra Urbanistikës, ekspertë teknikë, | 500,000 Lek | Projektet do të fokusohen në propozimet e bëra në Planin e Përgjithshme Rregullues në strukturën urbane si dhe në rjetin rrugor. |
| | C4b1 | Përgatitja e projekteve teknike nga ana e zyrës së projektimit në Bashki për formën dhe mënyrat e ndërhyrjeve fizike në kopshte dhe shkolla | Zyra e Urbanistikës, ekspertë teknikë | 200,000 Lek | Qëllimi i projekteve është që të përgatisin bazën e nevojshme teknike që mundëson investimet dhe ndërhyrjet konkrete |
| | C4c1 | Ngritja dhe konsolidimi i këshillave prindërore në të gjitha shkollat e Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, drejtoritë e shkollave | 50,000 Lek | Grupet duhet të kenë statuset e tyre përkatëse si dhe planet e punës |
| | C4c2 | Organizimi i mbledhjeve periodike me grupet mësimore dhe me prindërit për të diskutuar përmirësimin e kushteve të mësimin në shkollat e Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, drejtoritë e shkollave | 50,000 Lek | Takime të tilla duhet të promovojnë edhe mundësinë e gjetjes së fondeve alternative për ndërhyrjet në shkolla dhe kopshte |
| | C5a3 | Organizimi dhe financimi periodik i proceseve të mbjelljes së drurëve përgjatë rrugëve dhe zonave përgjatë brigjeve të lumenjve Drin dhe Gjadër si dhe në Parkun Periferik të qytetit | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit, firmë e kontraktuar | 1,000,000 Lek | Proçesi i mbjelljes së drurëve përgjate akteve rrugore duhet të respektojë profilet tërthore të propozuara në Planin e Përgjithëm Rregullues si dhe Planin Strategjik të Zhvillimit |
| | C7a2 | Kryerja e gjelberimit periodik të varrezave publike | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit | 50,000 Lek | |
| | C9a1 | Organizimi i kurseve të ndryshme periodike të trainimeve profesionale për grupet në nevojë në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë | 200,000 Lek | Kurset duhet të adresojnë krijimin e mundësive për punësim të grupeve në nevojë në Bashkinë Vau i Dejës, |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| D-Qeverisja e Mirë | D2a1 | Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës bashkiake në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 100,000 Lek | Gazeta e Bashkisë duhet të botohet çdo vit, në bazë mujore. |
| | D2a2 | Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të zyrave të ndryshme | 0 Lek | Raporti duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në arritjen e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të identifikojë masat e nevojshme për përmirësim të situatës |

4.2.6 Plani i Veprimit për vitin 2013

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|--------------------------|------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A2c2 | Organizimi i takimeve me operatorë të ndryshëm ekonomike turistike ku të promovohen zonat e mundshme turistike të liqenit si dhe nevojat për bashkëpunim | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të turizmit | 100,000 Lek | Fillimisht është e nevojshme krijimi i një liste të posaçme operatorësh dhe kontaktesh me investitore në fushën e turizmit. Bashkia Vau i Dejës duhet të identifikojë paraprakisht se cilat do të jenë mundësitë që ajo duhet tu ofrojë investitorëve të mundshëm. |
| | A2c3 | Përmirësimi periodik të faqes zyrtare në internet për Liqenin Artificial të Vaut të Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit si dhe ekspertë kompjuterikë | 100,000 Lek | Promovimi i zonës liqenore duhet të përmbajë imazhe të zonës, të dhëna fizike dhe infrastrukturore etj. |
| | A3b2 | Kryerja e investimeve periodike vjetore përmirësuese duke u bazuar në Studimet Pjesore të përgatitura si dhe në Projektet teknike, të listuara në Planin e Punës së Bashkisë | Zyra e Urbanistikës si dhe e Investimeve | | Shifra e investimeve do të varet nga vendimi dhe miratimi në Këshillin Vendor |
| | A4b3 | Kryerja e investimeve të vogla periodike për infrastrukturën fizike në zonë | Bashkia Vau i Dejës | 1,000,000 Lek | Në këtë proces, Bashkia mund të bashkëpunojë edhe me investitorë të interesuar, duke rritur kështu nivelin total të investimit. |
| B-Menaxhimi i Territorit | B3b1 | Pastrimi i zonave urbane dhe i kanaleve të ujit nga mbeturinat e pagrumbulluara si dhe depozitimi i tyre në pikën aktuale të grumbullimit | Bashkia, firmë e kontraktuar. | 1,000,000 Lek | Buxheti i propozuar mund të konsiderohet në shifra minimale, ndërkohe që Bashkia mund të eksplorojë mundësi të tjera financimi në nivel qendror dhe rajonal. Kuadri mbështetës duhet të jetë përmirësimi i imazhit të Bashkisë, në lidhje me zhvillimin e turizmit |

| Objektivat e Zhvillimit | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| B-Menaxhimi i Territorit | B3b2 | Gjelbërimi i korridorit kryesor rrugor sidomos përgjatë fshatit Mjedë dhe rrugës hyrëse për në qytetin e Vaut të Dejës | Zyra e Urbanistikës, Zyra e Koordinim Zhvillimit | 500,000 Lek | Qëllimi i këtij procesi është përmirësimi i imazhit të Bashkisë, në mbështetje të zhvillimit të turizmit dhe rritjes së numrit të vizitorëve. |
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C4c2 | Organizimi i mbledhjeve periodike me grupet mësimore dhe me prindërit për të diskutuar përmirësimin e kushteve të mësimin në shkollat e Bashkisë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, drejtoritë e shkollave | 50,000 Lek | Takime të tilla duhet të promovojnë edhe mundësinë e gjetjes së fondeve alternative për ndërhyrjet në shkolla dhe kopshte |
| | C5a3 | Organizimi dhe financimi periodik i proceseve të mbjelljes së drurëve përgjatë rrugëve dhe zonave përgjate brigjeve të lumenjve Drin dhe Gjadër si dhe në Parkun Periferik të qytetit | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimin, firmë e kontraktuar | 1,000,000 Lek | Proçesi i mbjelljes së drurëve përgjatë akseve rrugore duhet të respektojë profilet tërthore të propozuara në Planin e Përgjithshëm Rregullues si dhe Planin Strategjik të Zhvillimit |
| | C7a1 | Projektimi i sistemimit të hapësirave të brendshme të varrezave publike | Zyra e Urbanistikës | 0 Lek | |
| | C7a2 | Kryerja e gjelbërimit periodik të varrezave publike | Ndërmarrja e Pastrim Gjelbërimit | 50,000 Lek | |
| | C9a2 | Përgatitja e Projekt Propozimeve të ndryshme për donatorët, për financimin e projekteve të ndryshme të punësimit social për grupet në nevojë në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 0 Lek | |
| | C9b1 | Financimi i projekteve të infrastrukturës në territorin e Bashkisë Vau i Dejës ku të punësohen përfaqësues të grupeve në nevojë | Bashkia | 1,000,000 Lek | Qëllimi i këtyre projekteve është stimulimi dhe aktivizimi i grupeve në nevojë si dhe gjenerimi i fondeve të tjera nëpërmjet institucioneve financuese të ndryshme |
| D-Qeverisja e Mirë | D2a1 | Përgatitja dhe shpërndarja e gazetës bashkiake në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 100,000 Lek | Gazeta e Bashkisë duhet të botohet çdo vit, në bazë mujore. |
| | D2a2 | Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e Bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të zyrave të ndryshme | 0 Lek | Raporti duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në arritjen e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të identifikojë masat e nevojshme për përmirësim të situatës |
| F-Rritja e të Ardhurave Vendore | F2a3 | Financimi i emsioneve televizive që trajtojnë mundësitë për zhvillimin e turizmit natyror dhe historik në Bashkinë Vau i Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të informacionit | 300,000 Lek | Në këtë proces mund të përdoren mediat në qytetin e Shkodrës |
| | F2b1 | Organizimi i konkurseve dhe panairove në nivel rajonal ku të ftohen biznese dhe sipërmarrës të ndryshëm si dhe të promovohen mundësitë dhe potencialet për investime në këtë Bashki | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 200,000 Lek | |

2.4.7 Plani i Veprimit për vitin 2014

| Objektivat e Përgjithshëm | Kodi | Aktivitetet e propozuara | Aktorët përgjegjës | Buxheti Indikativ | Shpjegime |
|-------------------------------------------------|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| A-Zhvillimi Ekonomik | A3b2 | Kryerja e investimeve periodike vjetore përmirësuese duke u bazuar në Studimet Pjesore të përgatitura si dhe në Projektet teknike, të listuara në Planin e Punës së Bashkisë | Zyra e Urbanistikës si dhe e Investimeve | | Shifra e investimeve do të varet nga vendimi dhe miratimi në Këshillin Vendor |
| B-Menaxhimi i Territorit | B3b2 | Gjellbërimi i korridorit kryesor rrugor sidomos përgjatë fshatit Mjedë dhe rrugës hyrëse për në qytetin e Vaut të Dejës | Zyra e Urbanistikës, Zyra e Koordinim Zhvillimit | 500,000 Lek | Qëllimi i këtij procesi është përmirësimi i imazhit të Bashkisë, në mbështetje të zhvillimit të turizmit dhe rritjes së numrit të vizitoreve. |
| C-Përmirësimi i Shërbimeve dhe Infrastrukturave | C7a2 | Kryerja e gjellbërimit periodik të varrezave publike | Ndërmarrja e Pastrim Gjellbërimit | 50,000 Lek | |
| | C7a3 | Asfaltimi i rrugës së varrezave publike | Bashkia Vau i Dejës | 1,000,000 Lek | Rëndësia e asfaltimit të kësaj rruge vjen për shkak të pozicionit të rrugës në hyrje të qytetit të Vaut të Dejës, dhe përmirësimit të imazhit urban që ajo sjell |
| D-Qeverisja e Mirë | D2a1 | Përgatitja dhe shpërndarja e gazetes Bashkiake në Vaun e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 100,000 Lek | Gazeta e Bashkisë duhet të botohet çdo vit, në bazë mujore. |
| | D2a2 | Përgatitja e raportit vjetor për aktivitetet e bashkisë, investimet dhe ndërhyrjet e realizuara në Bashkinë Vau e Dejës | Zyra e Koordinim Zhvillimit, ekspertë të zyrave të ndryshme | 0 Lek | Raporti duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në arritjen e objektivave të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe të identifikojë masat e nevojshme për përmirësim të situatës |
| F-Rritja e të Ardhurave Vendore | F2b1 | Organizimi i konkurseve dhe panairëve në nivel rajonal ku të ftohen biznese dhe sipërmarres të ndryshëm si dhe të promovohen mundësitë dhe potencialet për investime në këtë Bashki | Zyra e Koordinim Zhvillimit | 200,000 Lek | |

4.3 Skema e Monitorimit dhe Treguesit Përkatës

Zbatimi i sukseshëm i Planit Strategjik të Zhvillimit në Bashkinë Vau i Dejës kërkon domosdoshmërisht konsolidimin e një sistemi të mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi periodik. Në këtë mënyrë bëhet e mundur evidentimi i problemeve që mund të hasen gjatë zbatimit të Planit si dhe të ndërmerren ndryshimet apo adaptimet e nevojshme. Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë i referohet një periudhe të shkurtër kohore 2008 – 2014, dhe në këtë mënyrë është tepër e rëndësishme që të shoqërohet me një proces i vazhdueshëm vlerësimi dhe përshtatjesh të nevojshme.

Duke qenë se Plani është një dokument strategjik në shërbim të institucionit të Bashkisë Vau i Dejës, është e natyrshme që zbatimi dhe monitorimi i tij të ecë në sinkron me proceset e përzgjedhjes dhe konsolidimit të strukturave bashkiake sipas fazave elektorale të pushtetit vendor në Shqipëri. Në këtë mënyrë sigurohet edhe përshtatja e propozimeve të Planit Strategjik të Zhvillimit si dhe monitorimi i zbatimit të tij me ciklet e planifikimit vjetor dhe buxhetimit të administratës vendore.

Bazuar në Ligjin për Financat Publike, përgatitja e Projekt Buxhetit për tre vitet në vazhdim, është një proces që duhet të finalizohet në Muajin Korrik të çdo viti. Ky Projekt Buxhet bazohet në Udhëzimin e Qeverisë Qëndrore për përgatitjen e Projekt Buxhetit në periudhën Qershor Korrik. Ky Projekt Buxhet parashikon shpenzimet dhe investimet e Bashkisë Vau i Dejes për tre vitet në vazhdim, ndërsa Plan

Buxheti, që përgatitet dhe miratohet nga Këshilli Vendor si dhe nga Prefektura Shkodër brenda Dhjetorit, trajton vetëm vitin pasardhës. Përgatitja e Projekt Investimeve për Grantet Konkurruese është një proces që duhet të përfundojë deri në 1 Nëntor të çdo viti. Plan Buxheti vjetor mund ose jo të përfshijë keto projekte në strukturën e vetë.

Skema e Propozuar e Monitorimit

| Aktiviteti i Propozuar | Afati Kohor (për çdo vit) | Aktorët Përgjegjës | Lidhja me Planifikimin dhe Buxhetimin Vjetor |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vlerësimi 6 mujor i aktiviteteve të Planit të Veprimit të PSZH. Përgatitje e Progres Raportit | Prill - Maj | Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit | Duke u bazuar në rezultatet e 6 mujorit, Bashkia mund të përcaktojë ndryshimet në Projekt Buxhetin që dorëzohet në Korrik. |
| Takime publike me qytetarët për rezultatet e zbatimit të PSZH. | Qershor - Korrik | Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit | Ndikojnë në adoptimet e nevojshme të aktiviteteve në Plan Buxhetin final |
| Takim i stafit të administratës së Bashkisë për të diskutuar progresin si dhe ndryshimet e nevojshme. | Tetor Nëntor | Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Bashkisë | Takimi do të finalizojë ndryshimet dhe adoptimet e nevojshme të Planit të Aktiviteteve që do të reflektohen në Buxhetin e ri vjetor të Dhjetorit. |
| Takim vjetor për Vlerësimin dhe Monitorimin e PSZH Përgatitje e Raportit Vjetor | Nëntor | Njësia e Koordinimit dhe Zhvillimit – Kryetari i Bashkisë | Takimi final i paraprin finalizimit dhe dorëzimit të Buxhetit Vjetor të Bashkisë. |

Në fund të çdo vlerësimi Grupi i Punës duhet të dorëzojë një raport përmblendhës i cili do të paraqitet para Këshillit Bashkiak. Ky i fundit ruan të drejtën që për çdo rast të bëjë kërkesë për raportim shtesë nëse e gjykon të nevojshme.

PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË BASHKISË VAU I DEJËS